



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XIV i botimit, nr. 157, Nëntor 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Shpallen të Lumë 38 Martirët e Kishës Katolike në Shqipëri

6

“Sa më i madh materiali për përzgjedhje, aq më e mirë cilësia e produktit përfundimtar”, thotë Darvini. “Nga ferra e vogël, del lepuri i madh”, thotë populli shqiptar. Le të lemë mënjane për një çast konotacionet negative të fjalë “lepur” dhe “ferrë” dhe të ndalemi në zbërthimin e kësaj shprehjeje frazeologjike, e cila bie ndesh me parimet e logjikës dhe ligjet e natyrës, por çuditërisht gjen zbatim në gjirin e kombit shqiptar. A nuk është mishëim i përkryer i kësaj shprehjeje fakti se në një vend të vogël prej më pak se tre milionë banorësh, ku popullsia e krishterë është në pakicë numerike, dolën jo pak, por 38 martirë të Kishës Katolike brenda një harku kohor shumë të shkurtër?...

Presidenti Nishani në dekorimin me urdhrin “Flamuri i Kombetar”, të 38 Martirëve të Kishës Katolike: Shteti shqiptar ju kërkon sinqerisht dhe përunjësisht: Ndjesë! Ju kërkon falje dhe ju shpreh pendesë!



Me **Dekoratën** e lartë të “**Flamurit Kombëtar**” u çmuan nga Kreu i Shtetit shqiptar: “Imzot Vinçenc Prennushi, OFM; Imzot Frano Gjini; Imzot Jul Bonati; Atë Mati Prendushi, OFM; Atë Serafin Koda, OFM; Atë Karl Serreqi, OFM; Atë Gjon Shllaku, OFM; Atë Gaspër Sumës, OFM; Atë Çiprian Nikaj, OFM; Atë Giovanni Fausti, SJ; Atë Bernardin Palaj, OFM; Atë Daniel Dajani, SJ; Dom Alfons Tracki; Dom Anton Muzaj; Dom Anton Zogaj; Dom Dedë Malaj; Dom Dedë Plani; Dom Dedë Maçaj; Dom Ejëll Deda; Dom Jak Bushati; Dom Lazër Shantoja; Dom Lekë Sirdani; Dom Luigj Prendushi; Dom Mark Xhani; Dom Mikel Beltoja; Dom Ndre Zadeja; Dom Pjetër Çuni; Dom Shtjefën Kurti; Dom Marin Shkurti; Dom Ndoc Suma; Dom Josef Markseni; Dom Josif Papamihali; Vëlla Gjon Pantalia, SJ; Marije Nikollë Tuci; Fran Mirakaj; Gjelo Shllaku; Mark Çuni dhe Qerim Sadiku”

DOKTORI QË U NDERUA ME BUSTE E DEKORIME

- KUJTIME NGJA SHOKU I BANKËS -

Ishte 1 shtatori i vitit 1972, plot 44 vjet më parë, sapo fillova mësimet në shkollën e mesme Mjekësore në Shkodër, dega Stomatologji. Fati e deshi që profesoresha kujdestare Myzejen Cufi (Çanga), njëkohsisht Drejtoreshë e Shkollës, më caktoi në bankën e parë me Prelë Gjelo Shllakun...

100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

FILLIMET E ARSIMIT 8 VJEÇAR, NË GIMAJ - DUKAGJIN

2

E ripërsëris se një ndër anët më pozitive, që regjimi totalitar ka pasur, ka qenë zhvillimi, masivizimi dhe cilësia e arsimit në çdo skaj të Shqipërisë, pra edhe në çdo fshat të Dukagjinit sado i largët ka qenë. Unë do të sjell një copëz nga këto arritje në fshatin Gimaj, periudhën të cilën e kam jetuar vetë, duke dhënë edhe unë kontributin tim modest në hedhjen e themeleve të arsimit 8-vjeçar, sot 9-vjeçar, në Gimaj. E bëj këtë në kuadër të 100-vjetorit të arsimit në Dukagjin dhe 70 vjetorit të shkollës në Gimaj...

LËVIZJA SHUMË E PËRFOLUR E DUKAGJINIT, NË MUAJIN NETORIT 1926

9

- 90 VJET PËRBALTJE DHE HARRESE HISTORIKE -

Lëvizja e Dukagjinit e vitit 1926, e cila në mënyrë të tejskajshme është quajtur dhe vazhdon të quhet lëvizje separatiste, madje edhe antikombëtare, është nxitur, motivuar dhe dirigjuar nga elementët më të spikatur anti zgost si, Ndocë Gjelo Shllaku e Vas Kiri për Dukagjinin, Kolë Biba e Spiro Kosova për Pukën, Dodë Nikolla për Malësinë e Madhe, Sali Mani për Krasniqen dhe pa dyshim në krye të gjithëve ishte prifti katolik Dom Loro Caka, i cili ishte Komandanti i Përgjithshëm i kryengritjes. Spiro Kosova një eksponenti i njohur i kësaj Lëvizje në kujtimet e tij shkruan...

FESTA NACIONALE E AUSTRISË

4

Me datën 27 nëntor 2016, në mjediset e Hotel “Turizmi” u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja, Natalja Leqeja dhe Ambasadori i Austrisë në Tiranë, Johann Sattlerl...

Ndreke Luca, në pendën e Dr. Luigj Martini

5

NDREKË LUCA.... Krenari e Dukagjinit që e lindi... Njëra ndër ikonat e kulturës të qytetit të Shkodrës... Aktori, dramaturgu dhe “Artisti i popullit, me vlera kombëtare, sot u nderua në tempullin e kulturës, në Teatrin “Migjeni” të Shkodrës. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni”, zhvilluan ceremoninë e paraqitjes së librit, të autorit Dr. Luigj Martini...

100 VJET ARSIM DHE KULTURË NË DUKAGJIN

FILLIMET E ARSIMIT 8 VJEÇAR, NË GIMAJ - DUKAGJIN



Nga Prelë Shytani

E ripërsëris se një ndër anët më pozitive, që regjimi totalitar ka pasur, ka qenë zhvillimi, masivizimi dhe cilësia e arsimit në çdo skaj të Shqipërisë, pra edhe në çdo fshat të Dukagjinit sado i largët ka qenë. Unë do të sjell një copëz nga këto arritje në fshatin Gimaj, periudhën të cilën e kam jetuar vetë, duke dhënë edhe

unë kontributin tim modest në hedhjen e themeleve të arsimit 8-vjeçar, sot 9-vjeçar, në Gimaj. E bëj këtë në kuadër të 100-vjetorit të arsimit në Dukagjin dhe 70 vjetorit të shkollës në Gimaj.

Në vitet e para të pas çlirimit, imediate u bë zhdukja e analfabetizmit, që u hapën kurse në çdo fshat, të cilët i drejtonin njerëzit, që kishin një farë arsimit autodidakt, të cilët edhe më vonë mbeten mësues fillloreje, për pak kohë. Pastaj u bë arsimiti fillor i detyrueshëm, duke hapur shkollat në çdo fshat. Në Gimaj shkolla fillore është hapur në vitin 1946, në vendin e quajtur Gjytet, afër Qytezës së Dakajve, sepse aty vinin nxënës edhe nga fshati Nën-mavriq. Mësues i parë ka qenë Eljaz Berberi, pastaj Njac Nenshati, Jak Deda e të tjerë.

Sigurisht, që nuk do të merren me historikun 70 vjeçar të shkollës në Gimaj, sepse donë një studim të thellë e shume kohë, por do të paraqes vetëm fillimet e arsimit 8 vjeçar, që i përket viteve 1968-1969. Mbas zhdukjes së analfabetizmit dhe konsolidimit të arsimit fillor (sot cikli i ulët), lindi nevojë imediate për rritjen e arsimimit të popullit ku, me një vendim të qeverisë së kohës u vendos, që në të gjithë vendin të kemi një arsim 8 vjeçar të detyrueshëm, duke filluar që nga viti 1968, që edhe në Gimaj ekzistonte deri atëherë një arsim 8 vjeçar i detyrueshëm i pjesshëm, sepse edhe në Dukagjin kishte disa shkollat 8 vjeçare si: në Breg lum, Theth, Palaj-Shosh dhe Xhan të Pultit. Ishin të detyruar të vazhdonin mësimin në këto shkollat nxënës, që ishin me banim në një largësi të caktuar nga shkollat përkatëse, kurse pjesa tjetër vazhdonin shkollën 8 vjeçare sipas dëshirës. Në Shtator të vitit 1968 u hapën klasat e pesta në Gimaj, Abat, Lotaj, Vuksanaj, Ndrejaj, Toplanë, Kir, Plan e të tjera. Për të dhënë mësim në këto klasa të pesta u caktuan mësues të rinj, kryesisht me arsim të lartë si: unë në Gimaj, Pjeter Smakaj në Abat, Mirash Ndrejaj në Lotaj-Vuksanaj, Fran Dardha në Toplanë, Ymer Sterniqi në Kir, Tef Topalli në Plan e të tjerë.

Në vitin e parë të ngritjes së këtyre shkollave të reja, ato ishin në varësi të shkollave ekzistuese. Kështu, të gjitha shkollat e zonës së Shalës, me përjashtim të Thethit, ishin në varësi të shkollës 8 vjeçare Breglumi, me drejtor z. Harun Haruni, nga Shkodra. Në klasën e pestë, në Gimaj u regjistruan 35 nxënës, të cilët ishin nga fshati Gimaj dhe

nga lagjia Dakaj e fshatit Nën-mavriq, duke realizuar 100 % planin e edukimit. Nxënësit e lagjes Mëkshaj, të fshatit Nën-mavriq vijonin mësimet në Breglumi. Strukturat e arsimit nuk na kanë vënë në dispozicion asnjë dokument të asaj kohe, por ne do të “shtrydhim” kujtesën për të hedhë pakëz dritë për ato vite. Kujtoj me shumë respekt nxënësit e mijë të pare. Nga Nën-mavriqi, Gjon Daka, Nikoll Luca, Gjini Luca, Dukate Luca, Mri Luca, Gjelojsh Ndreshaj, Mhill Malaj, Gjini Fusha, Lekë Koçeku, Pashkë Daka. Ndërsa nga fshati Gimaj, Mark Bobnaj, Kol Ftoni, Mhill Gjinesha, Gjon Ndou, Lenë Cuku, Luigj Nika, Sokol Vuksani, Mhill Foleta, Mhill Molla, Gjini Tthermja, Pal Qafnena, File Ndou, Age Dhinishta, Lulë Lucaj, Pal Mhilli, Marie Deda, File Pushimi, Frrok Shytani, Mirash Bognaj, Linë Prroj, Lizë Bungu, Mri Vata, Mhill Ndou, Nikollë Mark Gjelojshi, Shaqe Kola. Mësimin e zhvillonim në një dhomë të shtëpisë së Zef Gjergjit, në lagjen në Marvataj, në të cilën, pronari i saj, nuk jetonte aty. Si në çdo fillim, vështirësitë ishin të mëdha. Në këtë ndërtesë, në katin e dytë bënim mësim dhe në katin e parë strehoheshin disa bagëti të kooperativës. Edhe pse në kushte të pa përshtatshme, dhe pa mjete mësimore didaktike, nuk na pengonin që të kishim një mobilizim maksimal për ti përballuar vështirësitë dhe për të pasur arritje në procesin mësimor – edukativ. Mbasi i pajisëm të gjithë nxënësit me tekste e bazë e bazën materiale, filloi me shumë përkushtim të nxënësve duke qenë shumë të dhënë për t’u pajisur me sa më shumë dije edhe pse në familje kushtet i kishin shumë të vështira, se fëmijët më të shumtë nuk kishte kush t’i ndihmonte në shtëpi. Pjesa më e madhe ishin nxënës shumë të mirë, që mund të veçojmë, Gjon Daka, Mark Bognaj, Nikoll Lucaj, Lena Cuku, Pal Mhilli, Mhill Gjinesha, Gjelojsh Ndreshaj e të tjerë. Interesimi i prindërve, për atë që kishin mundësi, ishte shumë i mirë duke krijuar një trekëndësh barabrinjës mësues-nxënës – prind.

Përveç klasës së pestë, me mësues shkruesin e këtyre rreshtave, në fillore jepnin mësim mësueset e reja Mari Kola (Gila) dhe Lenë T’thermja, të cilat sapo kishin mbaruar shkollën e mesme pedagogjike “Shejnaze Juka”, në Shkodër. Kurse në Nën-mavriq jepnin mësim mësuesit Gjokë Pjetra dhe Zef Livadhi. Në vitin 1969 janë hapur shkollat fillore edhe në lagjet Gag e Kapre, të fshatit Gimaj, me mësuesit respektiv Mari Gila e i ndjeri Marash Staka. Në vitin shkollor 1969-70, të gjitha shkollat, në të cilat ishin hapur klasat e pesta një vit më parë, meqë u rrit numri i klasave dhe i mësuesve, u bënë drejtori më vete, pra edhe në Gimaj, në të cilën, unë kam nderin të jem drejtori i parë i kësaj shkolle. U larguam nga aty ku ishim si ambiente mësimdhënie, sepse pushteti vendor dhe ekonomia bujqësore përshtaten disa ambiente, në qendër të fshatit ku tashmë të gjashtë klasat e kësaj shkolle ishin në një vend. Patëm në ciklin e lartë, klasa pesë e gjashtë, me 69 nxënës, në ciklin e ulët ishin 93 nxënës. Në Nën-mavriq ishin 78 nxënës, në Gag ishin 31 nxënës dhe Kapre ishin 15 nxënës. Gjithsej, si drejtori me 286 nxënës. Në Gimaj mësues në ciklin e ulët ishin Çile Bardhi, Luce Dedushi e Zojë Marashi. Në ciklin e lartë Ded Mojsiu nga Barbullushi, Llesh Rushaj nga Bajza dhe drejtuesi i shkollës. Në Nën-mavriq, Gjok Pjetra e Zef

Livadhi, në Gag, Mari Gila dhe në Kapre, Marash Staka. Duke qenë popull shumë arsimdashës dhe në sajë të punës së lavdërueshme që pushteti vendor i kohës e bënte, u realizua 100 % plani i edukimit. Për të lehtësuar frekuentimin e nxënësve të lagjeve të largëta, në disa fshatra u hapën konvikte gjysmë shtetërore si: në Theth, Palaj, Plan e të tjera. Ata që mbaronin filloren nga lagja Kapre, vazhdonin ciklin e lartë në konviktin e Thethit. Vështirësitë objektive i kapërcyem me sukses, falë vitalitetit e përkushtimit në punë të mësuesve, ndihmesës, sidomos në plane mësimore, të seksionit të arsimit të asaj kohe me në krye shefin e palodhur dhe shumë të komunikueshëm, Qemal Byrazeri, si dhe të atyre me më shumë eksperiencë të shkollës 8 vjeçare Breglumi, me në krye drejtorin Muhamet Shala, i cili nuk u kursye duke na dhënë eksperiencën e tij.

Nga kontingjenti i parë i kësaj shkolle, pjesa më e madhe vazhduan shkollat e mesme të përgjithshme e profesionale në Koplik, Shkodër e sidomos Breglumi, ku hapja e shkollës së mesme përkon me kontingjentin e parë, që mbaruan klasën e 8-të në fshatra të ndryshme. Nxënësit, për të cilët po bëjmë fjalë, kudo që shkuan bënë diferencën në përvetësimin e dijeve dhe morën profesione të ndryshme si mjek, mësues, ushtarak, agronom, ekonomist e të tjera, të cilët vazhdojnë edhe sot të shquhen në profesionet e tyre si: Gjon Daka e Mark Bognaj në mjeksi, Lena Cuku (Bungaja) në arsim e të tjerë. Ka edhe nga ata që nuk jetojnë më, por që kanë lënë mbrapa emrin e mirë për punën e tyre siç ka qenë ish ushtaraku i ndjerë Luigj Nika.

Njëkohësisht me hapjen e shkollave të reja 8 vjeçare, për të cilat folëm, u hapën edhe shkollat e mbrëmjes siç quheshin atëherë. Merrnin pjesë partiakë, këshilltarë, quadro ekonomikë, të rinjë e të reja që kishin mbaruar klasën e 4-t disa vite para se të bëhej arsimi 8 vjeçar i detyrueshëm. Mësimi bëhej mbas pune, pra pjesa më e madhe në darkë. Ne që jepnim mësim sakrifikonim, por nuk e ndjenim lodhjen kur shihnim se interesimi, për të mësuar ishte i madh nga pjesëmarrësit. Në Gimaj vitin e parë të arsimit pa shkëputje nga puna frekuentonim rregullisht 31 vetë.

Kur mendjen ma rrëmbejnë kujtimet, gjithnjë kujtoj me nostalgji fillimet e punës si mësues i dalë direkt nga bankat e shkollës, sepse gjeta një ambient të ngrohtë. Nuk e ndjenim lodhjen, sepse nxënësit e kishin të madh përkushtimin për të përvetësuar dijet që u jepeshin nga librat apo mësuesi. Prindërit ishin shumë të angazhuar që fëmijët e tyre të ecnin sa më mirë duke na dhënë kompetencat e plota si dhe puna jonë ishte shumë e vlerësuar nga strukturat e pushtetit dhe instancat eprorë të arsimit, të cilat bënë që të shtonim mobilizimin në punë. Te gjitha këto bënë që të kishim rezultate të larta në procesin mësimor-edukativ. Arsimit gjithnjë vazhdoi të konsolidohet, shkollat u pajisën me mjetet e nevojshme didaktike.

Në vitin 1975, në Gimaj u ndërtua shkolla e re me të gjitha mjedise të mjaftueshme dhe shumë të përshtatshme për mësim. Edhe sot ekziston e rikonstruktuar shumë mirë vitet e fundit, në të

PROF. Dr. VUKSAN KOLA VJEN PARA LEXUESIT ME STUDIMIN “HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË”

Sa herë që marrim në dorë një libër të ri, të shkruar nga kushdo, është shumë kënaqësi, por kënaqësia shtohet edhe më shumë kur autorin e ke të njohur, të afërm, shok, apo mik.

Kohët e fundit është botuar dhe vënë në qarkullim libri më i ri i Profesor Dr. Vuksan Kola, “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë”.

Profesor Vuksan Kola, U lind në fisin Dragaj të Lekajve të Shalës në një familje me cilësitë më të mira tradicionale dhe bashkëkohore. Që herët morri rrugën e shkollimit në qytetin e Shkodrës deri në mbarimin e shkollës së mesme. Siç ishin rregullat e kohës, shkon në stazh, siç quhej në atë kohë, një vit si punëtor krahu në Hidrocentralin e Fierzës, prej nga bërë të gjitha përpjekjet për të vazhduar shkollën e lartë. Pati edhe pengesa, por gjithsesi me punën e tij arriti të shkonte në shkollën e lartë në Universitetin e Tiranës në degën e mjekësisë. Përkushtimi i tij e bëri një nga studentët më të mirë. Me mbarimin e shkollës emërohet mjek në klinikën e psikiatrisë në Qendrën Spitalore në Tiranë, sot “Nënë Tereza” duke punuar edhe si pedagog në fakultetin e mjekësisë.

Duke punuar dhe duke studiuar Prof. V. Kola erdhi duke rritur kualifikimin e tij dhe në vitin 1991 merr gradën “Kandidat i shkencave”, e cila u konvertua në “Doktor i Shkencave” në vitin 1993. Në vitin 2004, më 25 nëntor, mbrojt titullin “Profesor i Asociuar”. Pas një pune relativisht të gjatë dhe veprimtarie pedagogjike, klinike dhe shkencore, me 10 shkurt 2016 mori titullin “Profesor”.

Profesor Kola ka publikuar një numër të madhe referimesh e artikujsh shkencorë brenda e jashtë vendit, ka botuar e ribotuar shtatë libra e monografi të sferës profesionale, midis të cilëve edhe një përkthim nga gjuha angleze. “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë” që vjen tani përpara lexuesve është i vetëm në fushën e vet për nga shtrirja në kohë, përmasat dhe shumëllojshmëria e problemeve që trajton.

Shkrimi me saktësinë e duhur i “Historisë së Psikiatrisë së Shqipërisë” ishte një ndërmarrje e vështirë për Prof. V. Kolën, por ishte edhe një detyrim dhe përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe që po ndërmerre. Gjatë të gjithë kohës së punës mbi të, asnjëri prej këtyre komponentëve nuk i ka munguar për asnjë çast. Midis përkushtimit dhe vështirësive, kjo ishte hera e parë që përshkruhej historia e psikiatrisë shqiptare, në këto përmasa dhe me këtë shtrirje në kohë. Puna e bërë nga Prof. Kola është një bazë për breza të tjerë që do të vijnë më pas dhe patjetër do të përmirësojnë evidentimin e ngjarjeve të saj. Ata kanë një mundësi shumë të madhe, më shumë, sepse nuk do të kenë përpara një fushë të pashkelur apo një tokë djerr, por një truall të gërmuar me shumë kujdes, veçse jo

në mënyrë të përsosur. Prof. V. Kola thekson me force “se ishte domosdoshmëri fiksimi në letër i të vërtetave historike të kësaj fushe të vështirë të mjekësisë, sidomos në ditët e sotme kur, fatkeqësisht, herë pas here janë shfaqur prirje për të harruar, errësuar apo mbivlerësuar disa nga ngjarjet dhe aktorët e saj më kryesorë. Por historia vetëm mund të rishkruhet, ajo nuk mund të ribëhet asnjëherë”.



jëherë”.

Në faqet e librit, të vënë në dispozicion të lexuesve nga autori, gjejmë të dhëna që i kanë rrënjët thellë në histori. Ato i përkasin jo vetëm zhvillimi të psikiatrisë në vendin tonë, por edhe asaj botërore. Kujdes i veçantë është treguar për kërkimin, zbulimin dhe publikimin e të dhënave nga të gjitha periudhat e zhvillimit të shërbimeve psikiatrike në Shqipëri. Mungesa e gjatë e kësaj dege të mjekësisë apo edhe e degëve të tjera të saj gjatë pushtimeve të gjata e të ashpra nga të huajt, duke filluar me pushtimin turk, por edhe zhvillimi tepër i ngadaltë në të mëvonshmet, krijojnë vështirësi për evidentimin dhe vlerësimin e të dhënave, dokumenteve e fakteve të ndryshme historike. Autori bën një analizë të thellë dhe të kujdesshme të përparimit të mjekësisë tone dhe veçanërisht të asaj dege që merret me shëndetin mendor. Hapja e spitalit të parë në shërbim të të sëmurëve psikikë, në vitin 1921 në Vlorë, shënoi një kthesë shumë të rëndësishme në trajtimin e tyre. Dhe pikërisht këtu fillon historia e mirëfilltë e psikiatrisë shqiptare. Autori përshkruan me hollësi fillimet e publikimit të studimeve dhe të të dhënave mbi shkencën e Psikiatrisë që nisin në vitin 1959, kur, në vëllimin e parë “Punime të Psikonevrologëve”, pub-

likohen artikuj të disa prej mjekëve neuropsikiatër të atyre viteve. Më pas, në vitin 1962, Prof. Fejzi Hoxha botoi librin “Njoftime historike mbi zhvillimin e Mjekësisë në Shqipëri”, në të cilin zë vend edhe një historik i shkurtër i psikiatrisë. Shkrimet dhe referatet e mëvonshme, vëren autori i këtij punimi, u përkasin kryesisht dy profesorëve të psikiatrisë tonë, Prof. Xhavit Gjatës e Prof. Ulvi



Vehbiut, por të gjitha pasqyrojnë vetëm periudhën përpara vitit 1985. Shkrimet e mëvonshme historike janë të rralla dhe analizojnë probleme të veçanta të zhvillimit të psikiatrisë.

Prof. V. Kola, në vitin 2013, përshkruan për herë të parë, por në mënyrë shumë të shkurtuar, ngjarjet më të rëndësishme të historisë së Psikiatrisë së Shqipërisë deri në 31 gusht 2013. Mendimi për shkrimin e plotë të historikut të psikiatrisë së Shqipërisë kishte disa vite që ishte ideuar nga Prof. Kola. Ai mendonte se ishte në interes të të gjithëve, në radhë të parë të studentëve të mjekësisë, por edhe të profesionistëve të shumtë të shëndetit mendor, të njëjhej e gjithë rruga e zhvillimit të psikiatrisë tonë. Kjo u bë më e domosdoshme kur personalitetet më të mëdha të psikiatrisë shqiptare kishin filluar të largoheshin njëri pas tjetrit nga kjo botë dhe po bëhej gjithë e më e vështirë kryerja e kësaj detyre. Nxitje për autorin ishte edhe tendenca e shtrembërimit të historisë së psikiatrisë dhe të kontributeve të personaliteteve kryesore të saj.

Metoda e ndjekur nga autori ka qenë mbledhja e sa më shumë e materialeve historike nga burime të ndryshme, edhe duke takuar shumë mjekë të fushës së psikiatrisë dhe të dhënat e grumbulluara prej tyre, gjithnjë të depozituara në formën e dorëshkrimeve, ai i ka shfrytëzuar si burime bibliografike. Gjithashtu, autori i është drejtuar edhe burimeve elektronike,

por në mënyrë të kursyer. Materialin e mbledhur Prof. V. Kola e ka analizuar me shumë kujdes, duke bërë krahasime e ballafaqime të hollësishme. Si bazë në këtë botim ai ka pasur gjithë veprimtarinë pedagogjike, klinike, shkencore e botuese të Katedrës së Neuropsikiatrisë dhe drejtuesve të saj, e cila ishte krijuar në Tiranë në vitin 1952. Gjithashtu, me zhvillimin e psikiatrisë lidhej pazgjidhshmërisht edhe veprimtaria e gjithanshme e Shërbimit të Psikiatrisë së QSUT- së “Nënë Tereza”, mbasi aty kanë zhvilluar aktivitetin e tyre klinik, pedagogjik e shken- cor personalitetet më të shquara të saj. Ky institucion ka qenë gjithnjë qendra e zhvillimit dhe orientimit të strukturave psikiatrike në të gjithë Shqipërinë. Autori vlerë son edhe punën e bërë nga spitalet psikiatrike të rretheve. Por, përveç spitaleve dhe shërbimeve neuropsikiatrike në të gjitha qytetet, në historinë e psikiatrisë janë përfshirë edhe strukturat psikiatrike të organizuara nëpër institucione të tjera shtetërore, si edhe shërbimet psikiatrike private ose të krijuara e të mbështetura nga fondacione të huaja që zhvillonin veprimtarinë e tyre në vendin tonë.

Sigurisht që shkrimi për herë të parë i historisë së psikiatrisë tonë, edhe pse në përmasa të tilla, nuk mund të përfshinte të tërë njerëzit e angazhuar në strukturat e saj dhe të gjitha çështjet që lidheshin me të. Prandaj autori e ka vlerësuar të arsyeshme të shkruhej për mjekë psikiatër, neuropsikiatër dhe psikopediatër me grada ose tituj shkencorë, dekanë fakulteti, pedagogë të brendshëm e të jashtëm të lëndës së Psikiatrisë, drejtorë spitali ose shefa shërbimi e reparti psikiatrik. Në studimin e tij, Profesor Kola ka përfshirë edhe mjekë që kanë marrë vlerësime të ndryshme nga organe shtetërore ose organizma të tjerë kombëtarë apo ndërkombëtare, si shpallja “Qytetar nderi” ose përfshirja në “100 mjekët më të mirë të botës” e të tjera.

Përshkrimi i historisë së psikiatrisë së Shqipërisë në këtë libër realizohet përgjithësisht në formë ditari, ku regjistrohet çdo veprimtari e ngjarje e rëndë-

◀ cilën bëjnë mësim 2 mësues, me aq nxënës sa frekuentojnë parvarësisht sa janë të regjistruar. Duke parë nivelin e ulët të popullit të viteve 60-70, sepse edhe mjetet e in- formimit ishin të pakta, mësuesit nuk përtonin, që mbas procesit mësimor të bënin punë konkrete edukative me bashkësinë, jepnin informacione të ndryshme në të gjitha fushat e jetës.

Në qoftë se para shumë dekadash arsimi kishte progres nga viti në vit, sot deklarojmë me keqardhje se mbas viteve 90 arsimi ka pasur vetëm regres nga viti në vit. Ka vetëm një reklamë sipërfaqë-

sore, sepse shteti e strukturat e arsimit nuk interesohen fare për problemet e përmbajtjes, si asimilohet nga nxënësit programi mësimor dhe si është niveli i tyre shkencor. Edhe nëse diku punohet, kjo vjen vetëm në sajë të ndërgjegjes së trupës pedagogjike e jo nga kërkesa e llogarisë nga strukturat përkatëse të shteti. Shkolla është kthyer në “laborator” ku bëhen eksperimente. Janë futur nocione të “reja”, të cilat as mësuesit vet nuk i kanë të qarta. As dy shkolla fqinje nuk i kanë tekstet njëlloj, sepse arsimin e ka kapur për hunde privati. Është shtuar në mënyrë galoponte numri i analfa-

betëve të deklaruar e të pa deklaruar. Në çdo shkollë ka analfabet që vijojnë rregullisht mësimet. Disa nxënës mbarojnë shkollën e mesme dhe nuk dinë tabelën e shumëzimit apo rregullat më elementare drejtshkrimore. Deri kur kështu? Derisa strukturat e shtetit të vërë dorë seriozisht dhe konkretisht mbi arsimin në tërë përmbajtjen dhe problemeve që ka. T’i lënë lustrat, por të shtojnë kërkesën e llogarisë ndaj trupës pedagogjike, ti vënë ato në pozita pune, sidomos ndaj problemeve të përmbajtjes, për ta justifikuar misionin e shenjtë që kanë. Duhet të sensibilizohet e gjithë shoqëria për

problemet e shkollës dhe të paaftit e militantët të t’ua lënë vendin të aftëve që janë shumë por të pa punë.

Shpresojmë që edhe në Dukagjin të ketë përmirësime në procesin mësimor – edukativ, për ata nxënës që kanë mbetur atje, duke mos mbetur thjesht të regjistruar, por të konkurrojnë denjësisht me nxënësit e fushës dhe qytetit. Është e nevojshme që të përmirësohet infrastruktura shkollore dhe cilësia e mësimdhënieve. Edhe mësuesit dhe nxënësit dukagjinas kudo që janë të jenë shembull në përmbushjen e misionit, që ata kanë në përputhje me kërkesat e kohës.

Festa Nazionale e Austrisë

Me datën 27 nëntor 2016, në mje-diset e Hotel “Turizmi” u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, Gjergj Leqeja, Natalja Leqeja dhe Ambasadori i Austrisë në Tirane, Johann Sattlerl. Morën pjesë Presidenti i Miqësisë Shqipëri-Austri, Profesor Doktor Mahir Hoti, deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore të Bashkise Shkoder, të Qarkun Shkodër, Monsinor Angelo Massafro, Mjeshtri Fadil Kraja e Ahmet Osja, personalitete të tjera në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të qytetit tonë. Pasi, u ekzekutuan Himni i Republikës së Austrisë dhe i Republikës së Shqipërisë, Fjalën e rastit e mbajti , Konsulli i Nderit, Gjergj Leqeja.

Pastaj të pranishmit i përshëndeti Ambasadori i Republikës së Austrisë, në Tiranë, Johann Sattlerl.

Pastaj u dha një koketejl për pjesëmarrësit dhe vijoi festa në grupe-grupe.

Fjala e plotë e përshendetjes i Konsullit të Nderit të Republikës së Austrisë, Gjergj Leqeja

Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare, Të nderuar drejtues të pushtetit vendor, Të nderuar deputete të Parlamentit të Shqipërisë, I nderuar shkëlqesi Zoti Ambasador, Të nderuar miq,

Dëshiroj t’ju falënderoj për zemërsisht të gjithëve ju, për pjesëmarrjen në Festen Kombëtare të Austrisë dhe gjithashtu t’ju falënderoj për mbështetjen tuaj tashme në vitin e dymbëdhjetë të prezencës honorarë të Austrisë në Shkodër e njëherit në 60 vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Austrisë e Shqipërisë.

Festa e sivjetshme na mbledhë dhe për t’i thënë “mirëserdhe” Shkëlqesisë së tij, zotit Ambasador, Johnn Sattler, i cili përveçse një bashkëpunëtor i shkëlqyer i

Konsullatës së Nderit në Shkodër, është edhe miku i rrallës i Shqipërisë e sidomos

i Shkodrës. Ju bej me dije se në këto pak muaj qëndrim të tij në Shqipëri, është



Redaksia

sishme. Në disa raste analizohen ngjarje të veçanta, sidomos ato të mbas viteve 1990, duke evidentuar edhe mendimin personal të autorit ndaj tyre.

Prof. V. Kola, studimin e tij mbi historinë, e ka ndarë në katër periudha të ndryshme: në periudhën e kishave e të manastireve, në periudhën tranzitore, në periudhën shkencore dhe në periudhën e mbas viteve 1990, e cila është në të vërtetë vazhdim i periudhës paraardhëse, por me specifika krejt të veçanta që lidhen me zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe me hapjen e vendit me botën. Për herë të parë në këtë libër përfshihet e gjithë historia e psikiatrisë së Shqipërisë, prej fillimeve të para të saj deri me 31 dhjetor të viti 2014.

Një vëmendje e veçantë në librin “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë” i është kushtuar evidentimit të veprimtarisë së personaliteteve më të shquara të saj, të cilët gjatë gati një shekulli pune e përpjekjesh të vazhdueshme për të ecur përpara, kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin e kësaj shkence. Veprimtaria tyre e gjithanshme është arkivuar në memorien e mjekësisë shqiptare. Kujdes ka treguar autori për evidentimin në mënyrë më të zgjeruar të të dhënave për

disa mjekë, si Doc. Hiqmet Dibra, Dr. Mit Vokopola, Spiro Çipi etj., duke i vlerësuar si persona të rëndësishëm të psikiatrisë sonë, por, për arsye të ndryshme e të pashpjegjuara, janë lënë disi në hije ose nuk u është dhënë vendi i merituar.

Nga fundi i librit botohet për herë të parë lista emërore e të gjithë mjekëve psikiatër, neuropsikiatër dhe psikopediatër që kanë punuar në Shqipëri qysh nga fillimet e para të shërbimeve. Më pas ekspozohen fotografitë e pesë personaliteteve më të rëndësishëm të psikiatrisë shqiptare që nuk jetojnë më, në shenjë respekti e mirënjohjeje të pakufishme për kontributin e tyre të madh në zhvillimin e psikiatrisë tonë. Gjithashtu, në pjesën e literaturës, janë evidentuar të gjitha burimet e të dhënave, ku është mbështetur shkrimi i historisë së psikiatrisë. Autori ka shfrytëzuar 50 burime të ndryshme, por ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka shfrytëzuar me shumë vëmendje të dhënat dhe mendimet e një sërë kolegësh nga institucionet psikiatrike të ndryshme të vendit.

Libri mbyllet me treguesin alfabetik për termat, emrat dhe strukturat e ndryshme psikiatrike, të përdorur gjatë punës për hartimin e tij, i cili u shërben lexuesve për t’u orientuar me shumë lehtësi në kërkim të

gjithçkaje që u intereson në faqet e ndryshme të këtij historiku.

E di mire – shprehet autori – se shkrimi i “Historisë të Psikiatrisë së Shqipërisë” i mbetet borxh shumë kontributit të madh të gardës së personelit infermier, kujdestar e sanitar të spitaleve psikiatrike në Tiranë, Vlorë, Elbasan e Shkodër dhe në shërbimet psikiatrike ambulatorie të gjitha rretheve të tjera të vendit, të cilët me vite të tëra punuan me përkushtim të madh ndaj të sëmurëve mendorë. Profesor Kola mendon se përmasat e këtij libri nuk mjaftojnë të evidentohet edhe veprimtaria e tyre e çmuar, por sigurisht ata kanë qenë e vazhdojnë të mbeten ndihmësit e bashkëpunëtorët më të ngushtë të mjekëve, psikologëve e punonjësve socialë. Pa punën e tyre të palodhur nuk mund t’i dilej mbanë me sukses trajtimin të pacientëve të shumtë.

Prof. V. Kola tregon shumë mirënjohje dhe respekt, por dhe falënderon publikisht Dr. Irma Bekteshin dhe Dr.Valbona Alikajn që i kanë vënë me dashamirësi në dispozicionin konsulencën e tyre për probleme të ndryshme në interes të punës së tij studimore, për gatishmërinë e treguar për t’i ofruar të dhënat e tyre, të cilat hidhnin dritë mbi informacione të pa qartësuar mirë rreth personaliteteve dhe

prezent shume here në Shkodër e se gjate verës ishte dhe turist për dyjave në qytetin tone. I uroj për zemërsisht mikut tim, Johann Sattler, shume suksese të mëtejshme në punën e tij dhe shprehi bindjen e patundur që Ambasada e Republikës së Austrisë në drejtimin e Zotit Ambasador do të gjeje në Veriun e Shqipërisë e sidomos në Shkodër një ambient bashkëpunues e vlerësues të ndërsjelle për të evidentuar, zhvilluar e forcuar marrëdhëniet shume të ngushta e të ngrohta ndërmjet dy vendeve e popujve tone.

Java e veprimtarive për festën Kombëtare të Austrisë është e mbushur plot me evente, të cilat u hapen nga Shkolla Austriake në Shkodër “Peter Mahringer”, me datën 25 tetor, me një koncert të shkëlqyer artistik me nxënës të klasave të 8/9 –ta çka tregon për rritjen e konsiderueshme të interesit të familjeve jo vetëm Shkodrane për të regjistruar fëmijët në ketë shkolle, por sidomos të cilësisë së nxënësve, vazhduan me veprimtarin “Austria lexon” me të ftuar botuesin e grafitin Christian Thanhauser i shoqëruar nga Arian Leka e po vazhdon kaq bukur me prezencën tuaj e shoqërimitin e orkestrës nga pjesë nga Austria, për të cilën gjej rastin ti falënderoj për zemërsisht për prezencën.

Kuptohet, ato janë me ne sonte fale kujdesjes së Ambasadës Austriake në Tiranë e sidomos Z. Sattler.

Kjo është fryma, që sjell Austria në Shkodër dhe unë jam krenar që të përfaqësoj një komb me kaq shume dimensione kulture, zhvillimi dhe humanizmi. Jam po aq krenar për lidhjet mes kombeve tona që po forcohen dita - ditës dhe një tregues konkret është edhe pjesëmarrja e përvitshme juaja për të cilën edhe një here ju falënderoj në emër të Konsullatës së Nderit, në emër të Ambasadës dhe ti min personal!

Ju uroj çdo të mire për ju e familjet tuaja!

Edhe një here gëzuar Festen Kombëtare të Austrisë!

Faleminderit!

problemeve të rëndësishme të psikiatrisë shqiptare. Po kështu falënderon në mënyrë të veçantë Prof. Bardhyl Çipin, Dr. Dragush Totozanin, Ora Pelinkun, Dr. Miltiadh Veveçkën, Prof. Mentor Petrelën, Diana Ndroqin, Alma Alibalin, Laureta Selimajn, Dr. Anita Pilikën, Nikolin Lacajn, Elida Cangonjin, Ermira Shkupin, Sokol Preçin, Dr. Voltisa Gjergjin, Dr. Pasho Makutin, Izet Çullin, Ruzhdi Çelën, Avni Lamen etj. Autori çmon shumë edhe punën e mire që ka bërë mjeku psikiatër, Sadik Lala, në përpunimin me shumë kujdes dhe profesionalizëm të fotografive të botuara në këtë libër.

Së fundi, Profesor Kola falënderon për zemërsisht Zj. Suzana Vehbiu, që e ka pritur me shumë dashamirësi në shtëpinë e saj dhe i ka vënë në dispozicion të gjitha materialet që duheshin për të evidentuar veprimtarinë e gjithanshme të bashkëshortit të saj, Prof. Dr. U. Vehbiu.

Studime e botime të tilla meritojnë vëmendje, publikim dhe përhapje sa më të madhe, sepse i shërbejnë historisë, shkencës, kulturës dhe zhvillimit.

Urime Prof. Dr. Vuksan Kola!

Përgatiti **Luigj SHYTI**

Ndreke Luca, në pendën e Dr. Luigj Martini

NDREKË LUCA.... Krenari e Dukagjinit që e lindi... Njëra ndër ikonat e kulturës të qytetit të Shkodrës... Aktori, dramaturgu dhe "Artisti i popullit, me vlera kombëtare, sot u nderua në tempullin e kulturës, në Teatrin "Migjeni" të Shkodrës. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me Teatrin "Migjeni", zhvilluan ceremoninë e paraqitjes së librit, të autorit Dr. Luigj Martini, "Monografi - Nrek Luca". Një pjesëmarrje elitare, artistë, shkrimtare, kolege, gazetarë, miq dhe familjare.

Kumtesa, kujtime, falënderime, nderime, lot dhe emocione, të gjitha në një mbrëmje të paharruar. Duhet shumë rreshta që të përshkruaj madhësinë e këtij gjigandi të skenës dhe ekranit. Duhet shumë fjalë të paraqes kronikën e këtij aktiviteti. Ketë ceremoni e kishte përgatitur dhe e drejtoi shkëlqyeshëm, Astrit Fani. Folën: Gjovalin Çuni, Drejtori i Bibliotekës "Marin Barleti; Fadil Kraja, Mjeshtër i Madh; Eduard Grishaj, punonjës i bibliotekës së Muzeut Historik të Shkodrës; Zef Deda, Mjeshtër i Madh; Gjovalin Gjoka, aktor; Agron Dizdari, aktor i mirënjohur i teatrit "Migjeni", i cili i dhuroi një buqete me lule, bashkëshortes së Ndreke Luces, zonjës Mimika Luca.

Dr. Luigj Martini, autori i librit, falënderoi pjesëmarrësit, organizatorët dhe opinionet që u dhënë për të. Falënderoi Kryesinë e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për nderimin që i bën punës së tij.

Me vendim të kryesisë së Shoqatës u ndanë disa tituj nderi për:

Artisti i Popullit, Ndreke Luca, pas vdekjes, u nderua me titullin **"Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"**, me motivacion: *"Bir i nderuar i Dukagjinit, Artist i Popullit, që jetën, mendjen dhe zemrën ja kushtoi artit dhe kulturës kombëtare. Për realizmin me mjeshtëri të rrallë të dhjetëra karaktereve njerëzore në kinematografinë shqiptare. Emri dhe vepra e tij ja rritin vlerat Shqipërisë çdo ditë e më shumë"*.

Artisti i Popullit, Pjeter Gjoka, pas vdekjes, u nderua me titullin **"Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"**, me motivacion: *"Bir i nderuar i Dukagjinit, Artist i Popullit, që jetën, mendjen dhe zemrën ja kushtoi artit dhe kulturës kombëtare. Për vlerat e çmuara si regjisor, pedagog dhe përçues i fjalës artistike në skenë dhe ekran. Emri dhe vepra e tij ja rritin vlerat Shqipërisë çdo ditë e më shumë"*.

Artistja e Popullit, Tinka Kurti, u nderua me titullin **"Anëtare Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini"**, me motivacion: *"Bij e nderuar e Dukagjinit, Artiste e Popullit, Nder i Kombit, që jetën, mendjen dhe zemrën ja kushtoi artit dhe kulturës kombëtare. Për pasionin, përkushtimin*

dhe aftësi të shkëlqyera interpretuese në skenat shqiptare".

Autori i librit, Dr. Luigj Artini, u nderua me titullin **"Mirënjohja Martin Camaj"**, me motivacion: *"Intelektual i përkushtuar në hulumtimin dhe vlerësimin e figurave të veçanta me vlera kombëtare dhe shoqërore"*

Piktori Zef Muri, u nderua me titullin **"Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini"**, me motivacion: *"Pasqyrues*


i shkëlqyer vlerave të spikatura të lëmit etnografik të Dukagjinit për mes daltës dhe penelit të tij"

Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ne shenjë respekti e mirënjohje, për bashkëpunimin në organizimin e zhvillimit të veprimtarive në fushën e kulturës e të artit, i dhuroj Portretin e Artistit të Popullit dhe të Anëtarit të Nderit të Shoqatës, Ndreke Luca.

Për përgatitjen e zhvillimit të kësaj veprimtarie na mundësinë, Meritan Spahija (Drejtues i Shtëpisë Botuese FIORENTIA), Pal Lera dhe Mark Kulla, të cilët i falënderojmë dhe i urojmë me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Në fund, për pjesëmarrësit, nga familja e Artistit të Popullit, Ndreke Luca, në restorant "Peshku" u shtrua një koktej

Përgatiti Lulash Brigja



Shpallen të Lumë 38 Martirët e Kishës Katolike në Shqipëri

“Sa më i madh materiali për përzgjedhje, aq më e mirë cilësia e produktit përfundimtar”, thotë Darvini. “Nga ferra e vogël, del lepur i madh”, thotë populli shqiptar. Le të lemë mënjanë për një çast konotacionet negative të fjalë “lepur” dhe “ferrë” dhe të ndalemi në zbërthimin e kësaj shprehjeje frazeologjike, e cila bie ndesh me parimet e logjikës dhe ligjet e natyrës, por çuditërisht gjen zbatim në gjirin e kombit shqiptar. A nuk është mishëim i përkryer i kësaj shprehjeje fakti se në një vend të vogël prej më pak se tre milionë banorësh, ku popullsia e krishterë është në pakicë numerike, dolën jo pak, por 38 martirë të Kishës Katolike brenda një harku kohor shumë të shkurtër?

Pa dyshim që po.

Vetëm pak javë më parë, më datën 5 të këtij muaji, në një ceremoni madhështore të organizuar në katedralen e Shkodrës ku morën pjesë autoritetet më të larta të shtetit, personalitete të jetës kulturore si dhe mijëra besimtarë, Atë Vinçens Prennushi bashkë me 37 shokët e tij martirë, u shpallën të lumë me vendim të Selisë së Shenjtë. Qe një moment historik kur vëmendja e gjithë katolikëve të botës ishte kthyer në Shqipëri duke na ngjallur të gjithëve një ndjesi krenarie plotësisht të përligjur. Në vijim të Meshës së posaçme, e cila ishte pjesë e ceremonisë, Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi Metropolitan Shkoder-Pult dhe njëherësh Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore, i parashtroi në mënyrë solemne të dërguarit të Selisë të Shenjtë historinë e persekutimit të martirëve gjatë periudhës së diktaturës komuniste, arsyetimin se ata zgjodhën të flijoheshin për hir të besimit dhe të dashurisë për njerëzit, si dhe kërkesën për shpalljen e tyre të lumë duke i dorëzuar një kuti të drunj të me copëza nga eshtrat e njëmbëdhjetë martirëve që ka qenë e mundur të gjinden. Në mënyrë, po aq solemne, i dërguari i Vatikanit komunikoi vendimin e shumëpritur të Selisë së Shenjtë.

Kjo ngjarje e rëndësishme vjen në vazhdim të disa dëshmiave të njëpasnjëshme të përkujdesjes, vëmendjes dhe vlerësimit të Selisë së Shentë për Shqipërinë mes të cilave numërojmë: vizitën e Papës, shenjtërimin e Nënë Terezës, lumnimin e martirëve, si dhe emërimin e kardinalit të dytë Shqiptar, Dom Erenst Troshani.

Edhe shteti shqiptar nuk rri pas në shprehjen zyrtare të vlerësimit për martirët. Presidenti i Republikës, Z. Bujar Nishani, deklaroi pafajësinë e martirëve të Kishës Katolike ndaj akuzave të lëshuara gjatë regjimit të kaluar, dhe u akordoi Urdhërin e Flamurit, dekorata më e lartë e shtetit shqiptar.

Nuk është nevoja të themi se vlerat në të cilët martirët besonin janë themeli i një shoqërie në të cilën ta ka ënda të jetosh. Ajo që duhet të theksojmë është domosdoshmëria që martirët dhe rrethanat që i bënë të tillë, të kujtohen dhe të përmenden sa më dendur në mënyrë që t'i ketë parasysh brezi i ri për të mos shkarë në të njëjtat gabime historike në të ardhmen.

Fjala e plotë e Presidentit të Republikës, Sh. T. Z. Bujar Nishani në ceremoninë e dekorimit të 38 Martirëve të Kishës Katolike shqiptare:

“Kisha Katolike dhe klerikët e saj të rrënjosur në këtë tokë prej dhjetëra shekujsh janë kudo në inddet e këtij kombi qysh në ngjizjen e tij. Historia e këtij institucioni milenar në Shqipëri është sa histori ngadhënjimi, po aq edhe martirizimi, sa histori besimi, po aq edhe patriotizmi, sa histori fetare, aq edhe kulture, sa histori meshe, po aq edhe histori shkrimi, sa histori katolicizmi, aq edhe harmonie e bashkëjetese, sa histori shqiptare, po aq edhe evropiane e universale. Ajo është një trashëgimi e lavdishme e Shqipërisë, një realitet i vyer i saj.

Koha, ngjarjet, pushtimet, ideologjitë nuk e kanë kursyer së vëni në provë të rëndë, në provë ekzistence me mjetet e dhunës antike e ato të tiranisë moderne. Kjo Kishë, rregulltarët dhe besimtarët e saj nuk kanë zhgënjyer kurrë. Ata e kanë shprehur shumë herë të vërteten e tyre me martirizim duke ndezur dritën e Zotit, atë të gjuhës dhe kulturës shqiptare, të vetë idesë kombëtare sa herë ajo shuhej, duke mos iu frikur vdekjes aq sa ofronin jetën e tyre si dëshminë më të epërme të shpirtit dhe lirisë.

Nga Pal Engjëlli i Skënderbeut deri tek Hirësia e Tij Kardinal Ernest Troshani, lista është e gjatë, e gdhendur librave, mungadave, kuvendeve, betejave për pavarësi dhe shtetformim, hetuesive, gjyqeve dhe ployës së Komunizmit, por mbi të gjitha në vetë kujtesën e kombit mbi të cilën mbahet thagma shqiptare. E thënë me fjalët e Atë Gjergj Fishtës ajo rri si përmendore që nuk e dërrmon

as rrufeja e as moti. Tridhjetë e tetë të kësaj liste, të cilët gjithë jetën kishin jetuar dhe ushtruar vokacionin e tyre brenda formulës së shenjtë ‘Atdhe e fe’ teksa ndaheshin nga jeta tokësore py-



ngjarjet e rëndësishme të Shqipërisë duke filluar me Rilindjen Kombëtare, për të vazhduar me konsolidimin e shtetit të pavarur pas vitit 1912 dhe institucioneve akademike e pedagogjike.

Duhet thënë se brenda këtij grupimi rri edhe redaksia e revistës ‘Hylli i Dritës’.

Ata qysh në vitet ‘30-të paralajmëruan rrezikun që do të sillte bolshevizmi në Shqipëri. Po, të parët u përballen me hakmarrjen e tij duke krijuar modelin e qëndresës, të përballjes dhe të triumfit të njeriut të lirë ndaj tiranisë ideologjike që i kishte shpallur luftë Zotit dhe bijve të tij. Shkuan të vetëdijshëm drejt martirizimit, drejt qiellit. Me gjakun e tyre u shkrua himni i lirisë dhe demokracisë shqiptare. Papa Françesku, ky mik i madh i vendit tonë i shpalli ata të lumë duke i bërë pjesë së historisë së përbotshme e duke emancipuar kështu qëndrimin tonë mbi historinë kombëtare, duke na ftuar të ndahemi nga dogmat totalitare, duke na ftuar të refuzojmë versionet ideologjike që tento-

gjithëve në sy, – të regjimit komunist, pendesa e vërtetë dhe kokëulur, por mbi të gjitha, kërkesa e sinqertë për falje, drejtuar para të gjithëve familjarëve të viktimave të pafajshme për ato krime që janë kryer në ‘emër të popullit’, na ndihmon të gjithë si shoqëri shqiptare të shtrëngojmë radhët vëllazërisht e të ecim përpara pa pasur kurrë më frikë nga fantazmat e së kaluarës së errët diktatoriale.

Prandaj, në cilësinë e Kryetarit të Shtetit e ndiej të domosdoshme, sepse në radhë të parë ma kërkon ndërgjegjja ime si qytetar, që me shumë përunjësi, t’u kërkoj një falje të sinqertë, në emër të shtetit që më ka zgjedhur të shërbej e të jem me devotshmëri simboli i unitetit të popullit: familjarëve dhe pasardhësve të viktimave të panumërta të diktaturës komuniste, edhe atyre që ende nuk u janë gjetur as eshtrat, t’i kërkoj falje edhe Kishës Katolike shqiptare, por edhe kujdo tjetër, që u prek deri në palcë nga djepi e deri në varr, që u vra pafajësisht, u përndoq deri në tri breza, u internua padrejtësisht, që u dëmtua fizikisht, materialisht, por më tepër shpirtërisht, që u cenua rëndë në dinjitetin e vet njerëzor dhe që u privua nga të drejtat thelbësore dhe universale të njeriut, dhe që ndoshta vazhdon ende sot e kësaj dite të vuajë

pasojat e tmerrshme e gati-gati të pariparueshme të atyre krimeve makabre, të cilave iu vesh përsipër padrejtësisht petku se po kryheshin në emër të shtetit dhe të ashquajturës ‘luftë klasash!’

Shteti shqiptar sot, ju kërkon sinqerisht dhe përunjësisht: Ndjesë!

Ju kërkon falje dhe ju shpreh pendesë!

Të nderuar të pranishëm!

Sonte nga kjo sallë historike le t’i shqiptojmë emrat e tyre një nga një duke u përkulur me mirënjohje të thellë e përunjësi para kujtimit të tyre: Imzot Vinçenc Prennushi, OFM; Imzot Frano Gjini; Imzot Jul Bonati; Atë Mati Prendushi, OFM; Atë Serafin Koda, OFM; Atë Karl Serreqi, OFM; Atë Gjon Shllaku, OFM; Atë Gaspër Sumës, OFM; Atë Çiprian Nikaj, OFM; Atë Giovanni Fausti, SJ; Atë Bernardin Palaj, OFM; Atë Daniel Dajani, SJ; Dom Alfons Tracki; Dom Anton Muzaj; Dom Anton Zogaj; Dom Dedë Malaj; Dom

Dedë Plani; Dom Dedë Maçaj; Dom Ejëll Deda; Dom Jak Bushati; Dom Lazër Shantoja; Dom Lekë Sirdani; Dom Luigj Prendushi; Dom Mark Xhani; Dom Mikel Beltoja; Dom Ndre Zadeja; Dom Pjetër Çuni; Dom Shtjefën Kurti; Dom Marin Shkurti; Dom Ndoc Suma; Dom

nesh. Fatkeqësisht sado të çmeritur, shumë prej nesh jemi dëshmitarë të rikthimit të nostalgjive enveriste dhe të krenarisë kriminale për figurat e regjimit që u përmbys në vitin 1990.

Paradoksisht vjet ndodhi më e padëshirueshmja gjë. U vlerësuan me

Presidenti Nishani në dekorimin me urdhrin “Flamuri i Kombëtar”, të 38 Martirëve të Kishës Katolike: Shteti shqiptar ju kërkon sinqerisht dhe përunjësisht: Ndjesë! Ju kërkon falje dhe ju shpreh pendesë!



Me **Dekoratën** e lartë të “**Flamurit Kombëtar**” u çmuan nga Kreu i Shtetit shqiptar: “Imzot Vinçenc Prennushi, OFM; Imzot Frano Gjini; Imzot Jul Bonati; Atë Mati Prendushi, OFM; Atë Serafin Koda, OFM; Atë Karl Serreqi, OFM; Atë Gjon Shllaku, OFM; Atë Gaspër Sumës, OFM; Atë Çiprian Nikaj, OFM; Atë Giovanni Fausti, SJ; Atë Bernardin Palaj, OFM; Atë Daniel Dajani, SJ; Dom Alfons Tracki; Dom Anton Muzaj; Dom Anton Zogaj; Dom Dedë Malaj; Dom Dedë Plani; Dom Dedë Maçaj; Dom Ejëll Deda; Dom Jak Bushati; Dom Lazër Shantoja; Dom Lekë Sirdani; Dom Luigj Prendushi; Dom Mark Xhani; Dom Mikel Beltoja; Dom Ndre Zadeja; Dom Pjetër Çuni; Dom Shtjefën Kurti; Dom Marin Shkurti; Dom Ndoc Suma; Dom Josef Markseni; Dom Josif Papamihali; Vëlla Gjon Pantalia, SJ; Marije Nikollë Tuci; Fran Mirakaj; Gjeloš Lulashi; Mark Çuni dhe Qerim Sadiku”

Josef Markseni; Dom Josif Papamihali; Vëlla Gjon Pantalia, SJ; Marije Nikollë Tuci; Fran Mirakaj; Gjeloš Lulashi; Mark Çuni; Qerim Sadiku.

Të dashur miq,

Sonte jemi mbledhur në këtë ceremoni disi të vonuar solemne jo për t’u dhënë 38 Martirëve të Kishës katolike dhe të popullit shqiptar, atë çfarë u takon. Ata janë vetëdekoruar në altarin e sakrificës sublime. Në fakt lavdia e tyre s’ka nevojë për asgjë teksa dinjiteti ynë dhe standardet etike kanë nevojë për të. Më shoqëron një brengë teksa komunikoj me ju, sepse edhe në këtë moment që flasim shteti shqiptar nuk ka gjetur ende udhën të shfuqizohen të gjitha aktet e fajësisë politike me, të cilat gjykonte padrejtësia e diktaturës dhe t’i shpallë ata pafajshëm.

Sigurisht tejet më të lehtësuar e balëlartë do të ndihemi nëse një proces sa moral e aq gjyqësor do të funksionojë për të gjykuar xhelatët e tyre si një tentim për të rikthyer të drejtën mes

medalje shumë prej veglave më kriminale të diktaturës, njëri prej tyre ishte edhe hetuesi i At Zef Pllumit dhe Sami Repishtit. Deri këtu s’duhej të arrinim! Dukuria e estetizmit të krimit me emra tingëllues si ‘bunk art’ apo ‘shtëpi me gjethë’ po shndërrohet në një tendencë preokupuese ndërkohe që asnjë burg famëkeq apo kamp internimi nuk është pjesë e planeve muzeale të kujtesës. Tendencë e shndërrimit të historisë në legjendë popullore ka për qëllim manipulimin dhe relativizmin e krimit. Martirët mund të na falin shumëçka, por nuk do të na e falin kurrrë harresën dhe fshehjen e së keqes, së cilës iu kundërvunë me çmimin e jetës. Në vend të banaliteteve të realizmit socialist fëmijët tanë duhet të nxënë librat e tyre të dijes e të memories. Ata duhet të zënë vend në kurrikulat shkollore.

Dua të flas hapur me ju! Presidenti i Republikës nuk disponon asnjë mundësi ligjore veç aktit të faljes kur në fakt



Logoja e Martireve



Grafikë nga Luigi Mila

shpresojmë që ata që u martirizuan të na falin ne, dhe jo e kundërta. Ndaj propozoj sonte që Parlamenti shqiptar të hartojë një ligj të posaçëm për Gjykatën Speciale, duke ngarkuar Ministrinë e Drejtësisë, të iniciojë procesin e vonuar, por të domosdoshëm të rigjykimit me kërkesë dhënien e pafajësisë duke filluar me 38 Martirët si një masë e domosdoshme si dallim esencial të lirisë nga tirania, si reflektim i shoqërisë mbi të mirën dhe të keqen, si ndarje e saj me të kaluarën duke shëruar plagët e saj. Le të ushtrojmë për këtë qëllim të shenjtë çdo të drejtë qytetare që na jep Kushtetuta e vendit.

Të nderuar klerikë, të nderuar ambasadorë, të nderuar të pranishëm!

Ndihem i privilegjuar që më takoi mua si President i Republikës që t’i atashoj kujtimit të 38 Martirëve më të lartit Urdhër shtetëror, atë të Flamurit Kombëtar, për të cilin ata dhanë jetën. Ata pyesnin çfarë duhet të bëjmë më tepër për të qenë shqiptarë? Ne iu themi sonte çfarë duhet të bëjmë më tepër për t’ju merituar, për të marrë faljen dhe bekimin tuaj? Falë burrave si ju, iu drejtohem pikërisht Martirve se besoj në jetën e tyre të përtëjme, mund të përsërisim moton: ‘Ti Shqipëri na jep nder, na jep emrin shqiptar.’

Ju qoftë e lehtë lëndina nën hijen e Flamurit Kombëtar!

Ju faleminderit!”

Në mes të Martirëve të Lumnuem, dhe të dekoruar me urdhrin “Flamuri Kombëtar”, tetë janë dukagjinasi. Me lumtunimin e 38 martireve të Kishës Katolike Shqiptare, Papa Francesku dhe i gjithë kleri katolik japin një mesazh të ri për gjithë shqiptarët. Kombi ynë e në veçanti ne, që tetë prej tyre janë dukagjinasi dhe jemi gjaku i tyre, ndjehemi krenar për veprën e tyre, të cilët me shume vlerësuan besimin e lirinë, se sa jetën e tyre. Vepra e tyre duhet të jete shembull dhe i përjetësuar në memorien e çdo njeriu, e çdo dukagjinasi që e donë kombin e vet.

LAVDI MARTIREVE TË KISHËS KATOLIKE!

MIRËNJOHJE TË GJITHË ATYRE QË PUNUAN PËR TË NXJERRË NË DRITË VEPRËN E TYRE!



ATË BERNARDIN PALAJ OFM



ATË ÇIPRIAN NIKAJ OFM




DOM DEDË PLANI



ATË GJON SHLLAKU OFM



DOM LAZER SHANTOJA



DOM MIKEL BELTOJA



GJELOSH LULASHI



QERIM SADIKU

Mesazhi i kësaj ditë....

Zoti ynë, O zemërmire
dil e prit këta martire.
Këta engjëj të besimit
sot kanë ditën e Lumturimit ...
Zoti ynë kur na krijove
lindi lufta për pushtet.
Njeriu - hasmi i vetvetes
mohon Zotin edhe vret...?
Zoti ynë, O zemërmire
sot njerëzimin Ti bekoje...
Sepse etja për pushtet....
e ka prish paqen ndër lloje...
Zoti ynë që na krijove...
fali, fali disa “qyqe”,...
Flasin dhe mbjellin urrejtje..
fali, fali se s’ dinë ndryshe..?

Lulash Brigja

Shkodër, më 5 nëntor 2016

TË LUMNUEMIT E Jezu Krishtit

Rreze lëshoi drita e Perendisë
Në Shkodrën e lashtësisë
Të kulturës e qytetrisë
Më kollosët e historisë
Të vlersuem në Europë
Madhështia i njofti edhe në Botë
Për vlerat e mëdha të besimit

Kështjellë e fesë Krishtimit
Me martirët e shejtnimit
Te kisha e Madhe shumëvjeçare
Me histori të çmuar fetare
Në Sheshin e Shejtë Gjon Pali II-të
U shpalosën mrekullitë
Asht dita e historisë
Për martirët e Perendisë
Gëzimi dhe madhështia e Shqipërisë
Janë bijtë e shejtë të lavdisë
Në shkodrën e persekutimit
Lindë e rritë heronjtë e martizimit
Për mëshirën pranuan turturat e vdekjen
Për fenë e të vërtetën
Të vërtetën e mundimeve të Krishtit
Me aftësi të zemrës e shpirtit
Duruën tmerrin e komunizmit
Me mëshirën Hyjnore banë fljimin
U banë simbol paqe për njerëzimin
Zoti iu dha nderimin
Vendosë në Altar me Hyjnitë
Në jetën amshuar të pavdeksisë
Në testamentin e bekuem të lavdisë
Historia e shenjtë e Krishtimit
Shëmbulltyrë Hyjnore e njerzimit
Të shenjtë në jetën e vërtetë
E gjithë bota i përshendetë
Nga shume vende pjesë marrin

Përfaqësues fetarë me Vatikanin
Martirët madhështor e kishin idealin
Shpirti Shenjt mbi ta rreze lëshoi
Zoti vëejtjet ia lehtësoj
Shumë vëejtën e vdiqën në turtura
Nuk i mposhti plumbi, burgu as dhuna
Përballuen gjenocidin fetarë
Për fenë e idenë shqiptare
Ishin shume të vendosur
Komunizmi desht me i çfarosur
Ai ishte shume gjakatarë
Burgosi e pushkatoi patriot e fetarë
Me vullnesën e Krishtit muerën mëshirën Hyjit
Me shpirtin shenjt në zemër
Me mëshirën e Zotit u banë shëmbull
Në çastet e fundit tuj ndërrue jetë
U lutën “ Rroftë Krishti Mbret”
Me vullnesën e Zotit për mëshirë
Gjithçka duruan me dëshirë
Dëgjoni, o njerëzit e mirë!
Për hasmin kërkuan mëshirë
Me porositë e Krishtit amanet lan
“Fali Zot se s’dine çka bajne!”
Në testament formula e mëshës
Shkruer martirët e sakrificës
Me jetën që u mori komunizmi
Por forcën e besimin e kishin te Krishti
Sot me nderim i lumnoj Vatikanin

Martirët shqiptarë shejtorë i shpalli
Pesë nëntorin të lavdishëm e caktoj
Ditë shejte për jetë e ligjëroj
Për 38 martirët e sublimeve
Në kalvarin e mundimeve
Madhështore dy data të arta
Historia i vendosi të afërta
Me vlera shejtënore të verteta
Për martirët e Nënë Tereza
Dhurata të Zotit të vërtetë
Pa të cilën nuk ka jetë
Vepra madhore asht e gjallë
Për terrorin komunist janë deshmitarë
Në çastet e fljimit
Dhanë mesazhin e paqes e të pajtimit
Të gjithë botës e Krishtërit
Derdhën lotët e paqes e të pajtimit
Thirrje shpirtënore e mirëkuptimit
Me mëshirën e Zotit e të Hyjnit
Martirëve Krishti iu dha përjetësimin
Kombi shqiptar nderimin
Gjithë bota respektimin

Pjetër Geraj, Belgjikë, Nëntor 2016

Përgatitën Ndue Sanaj
e Vladimir Banushi

LËVIZJA SHUMË E PËRËFOLUR E DUKAGJINIT, NË MUAJIN NËTORIT 1926

- 90 VJET PËRBALTJE DHE HARRESE HISTORIKE -

Lëvizja e Dukagjinit e vitit 1926, e cila në mënyrë të tejskajshme është quajtur dhe vazhdon të quhet lëvizje separatiste, madje edhe antikombëtare, është nxitur, motivuar dhe dirigjuar nga elementët më të spikatur anti zogist si, Ndokë Gjeloşi e Vas Kiri për Dukagjinin, Kolë Biba e Spiro Kosova për Pukën, Dodë Nikolla për Malësinë e Madhe, Sali Mani për Krasniqen dhe pa dyshim në krye të gjithëve ishte prifti katolik Dom Loro Caka, i cili ishte Komandanti i Përgjithshëm i kryengritjes. Spiro Kosova një eksponenti i njohur i kësaj lëvizje në kujtimet e tij shkruan:

Programi i Kryengritjes (revolucionit) ishte:

A- Rrëzimi i regjimit të Zogut

B- Formimi i qeverisë provizore demokratike antif feudale nga forcat revolucionare, deri në zgjedhjet e përgjithshme

C- Përkrahja e klasës punëtore të shtypur nga bejlerët, agallarët çifligarët dhe luftë të pamëshirshme kundër çdo keqbërësi në popull

Ç- Shpallja e Republikës së Shqipërisë pa të drejtë ndërhyrje nga jashtë në punët e brendshme

D- Anulimi e menjëhershëm të çdo marrëveshje të dëmshme të kohës së regjimit Zogist, që cenon tërësinë tokësore dhe interesat e shtetit shqiptar nga ndonjë shtet i huaj. 1) "Dom Loro Caka kishte marrë përsipër organizimin e kësaj kryengritje dhe ishte në marrëveshje me Koço Tasin, i cili do të organizonte lëvizjen nga ana e Jugut". Dom Loro Caka mbajti një fjalim të shkurtër e plot kuptim, të cilin e mbylli me shprehjet: "Në qoftë se na dhimbet atdheu dhe populli shqiptar duhet të veprojmë dhe ja siç duhet bërë. Bafti i Zotit dhe pushka e Hotit!" 2)

Do të ishte me shumë interes të dihej se kush e kishte zgjedhë Komandant të Përgjithshëm Dom Loro Cakën?! Spiro Kosova në kujtimet e tija nuk e thotë këtë, por sipas tij Dom Loroja ishte një antizogist i kahershëm që kërkonte përmbysjen e Zogut nga vetë shqiptaret dhe vendosjen e një Republike Popullore, madje si tillë ishte eksponent shumë më i pranueshëm se një pjesë demagogëve të Bashkimit Kombëtar, që kapardiseshin kafeneve të Vjenës dhe prisnin fatin nga një fuqi e jashtme, kur të vinte koha për t'i thirrur e vendosur në kolltukë". 3) "Me Dom Loro Cakën bashkëpunuan, Dom Lazer Shantoja, Kapiten Mark Raka, Togër Ndokë Gjeloşi, nëntogër Kolë Bibë Miraka, Spiro Kosova, Ritvan Ohri, Vas Kiri dhe porsa u takuan për herë të parë mësuat se Loro Caka ishte Komandant i Përgjithshëm." 4) Mos vallë Dom Loroja ishte vetëshpallur Komandant i Përgjithshëm dhe ka folur në emër të kësaj komande apo është caktuar si i tillë nga ndonjë fuqi e huaj, që e ka shtyrë të bëjë këtë kryengritje. 5) Ngaqë eksponentët drejtues të kësaj lëvizje erdhën në Shqipëri nga toka jugosllave, italianët ua faturuan krejtësisht jugosllavëve këtë lëvizje, por që në fakt ishte një grackë e dyfishtë italo-jugosllave ndaj Zogollit, por shqarshi në kurth u ra vetëm italianëve, që u kurorëzua më së miri, me Paktin e Tiranës. (P. M, nënvizimi im) Duke u kthyer tek lëvizja e vitit 1926, Kolë Bibë Miraka dhe Spiro Kosova në ultimatumin drejtuar Llesh Marashit në kohën që kryengritësit kishin rrethuar Pukën thuhet se, "Nacionalizma shqiptare e përfaqësuar prej dëshirës së popullit ia dha vulën më rrëzue qeverinë dhe regjimin tradhtar të Ahmet Zogut". 6) Studiuesi Mentor Belevu në mënyrë të rafinuar aludon duke e quajtur Kryengritjen e Dukagjinit si një lëvizje separatiste të krishterë. "Me sa

duket Dom Loro Caka donte të vendoste një qeveri të krishterë, pas përmbysjes së qeverisë muhamedane të Ahmet Bej Zogollit." 7) Zakonisht më "ndoshta" nuk duhet të flitet në shkencë dhe aq më tepër të nxirret një konkluzion përfundimtar historik. Së paku, programi i mësipërm i ruajtur ashtu siç është në defterët personal të njërit prej drejtuesve luftarak të kësaj Kryengritje, siç ishte Spiro Kosova, por as në tërësinë kujtimeve të tij nuk shihet se ka ekzistuar një ide e tillë për krijimin e një qeverie të krishterë, as për kantonizimin e Shqipërisë sipas ndarjes fetare. Ta quash këtë kryengritje thjeshtë separatiste, qëllimin e klerit dhe të organizatorëve si qëllim reaksionar dhe antikombëtar do të thotë ta ideologjizosh politikisht tej masës duke rënë në pozita ekstremiste filo-zogiste. Për malësorët e Dukagjinit nuk kishte asgjë të përbashkët me atë që shpesh akuzohen në mënyrë ekstreme organizatorët e saj. Ata u ngritën të nxitur nga motive të tjera ekonomike dhe politike. Dukagjini ishte një vorbë e nxehtë e pakënaqësive antiqeveritare, që ziente prej kohësh dhe shpërtheu në nëntor 1926. Rrënjët e kësaj pakënaqësie ishin gjendja e keqe ekonomiko-shoqërore e popullatës dhe masat e ashpra të qeverisë ndaj tyre, gjë që është pranuar edhe nga vetë zyrtarët e Tiranës. Nga ana tjetër

me toka të pakta e varfanjake e numër të kufizuar bagëtish, për shkak të kushteve të ashpra të dimrave të egër alpin. Një vlerësim shumë objektiv për shkaqet e kësaj lëvizje të armatosur ka dhënë studiuesi Albert Mousset, në librin e tij "Shqipëria përballë Evropës". Ai nënvizon pa emocion, se ".... shkaqet e kësaj kryengritje janë tepër të koklavitura. Ato ishin një farë kundërveprimi, kundër "centralizmit" dhe "etatizmit" të qeverisë së Tiranës. Mëndimi i krijuar se qeveria e Zogut ishte qeveri e myslimanëve kundër katolikëve, si qeveri e bejlerëve kundër fshatarëve, qeveri e Shqipërisë së mesme (Tiranës dhe Durrësit) kundër Shqipërisë veriore janë njëra anë e medaljes. Ndërkohë shkaqet e tjera ishte edhe kriza e vazhdueshme për sendet dhe nevojat më parësore, pakënaqësia kundër Presidentit të Republikës, i cili kërkonte ofiqin e tij ta bënte të

Përrjetshëm." 8). Ky autor me pak fjalë shkoqitë një nga të gjitha shkaqet që çuan në shpërthimin e kësaj kryengritje, ndërkohë kur disa studiues shqiptarë të indoktrinuar me një të rënë lapsit e quanin thjeshtë vetëm separatiste. Kolonel Faik Quku në librin e tij "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore", vëllimi parë, 1939-1941, shkruan: "Në fund të vitit 1926, nacionalistët e ikur përgatitën një



Dode Nikolli, Zef Avdia, Zef Leka, Kole Gjeta e Leke Marashi

duhet t' mos harrojmë se bëhet fjalë për vitin 1926, kur asnjëherë deri në atë moment në Shqipëri nuk kishte pasur kurrë stabilitet politik, veç trazira dhe luftë për pushtet mes grupacioneve rivale, ku palët sulmonin ndjera tjetrën më shqyte e me ushtë sulmonte, duke e quajtur kundërshtarin armik, tradhtar, antikombëtar e të tjera.

Dukagjini ishte nga më të varfrat e trevave të Shqipërisë, i struktur në gjirin e maleve nga luftërat për mbijetesë gjatë robërisë së zezë otomane. Edhe pas një çerek shekulli, pas largimit të zgjedhës osmane nga qeveritë shqiptare nuk ishte bërë kurrfarë gjëje për përmirësimin e jetës në këto male, që akoma jetonin zbathur e zhveshur, të lekosur e të uritur, pa bukë (misrin, kripën dhe vajin e gurit ishin të detyruar ta blinin në Shkodër e ta transportin me zhaba në shpinë sa për të mbajtur frymën gjallë). Në mungesë të bukës kush nuk kishte me çfarë ta blinte, detyrohej të ushqehet me gështenja, patate dhe barishte të egra. Mbisundonte një ekonomi e mbyllur natyrore,

lëvizje të përgjithshme kundër Zogut, që do të pëlçiste si në veri ashtu edhe në jug të Shqipërisë. Për arsye të paditura dhe papritmas lëvizja fillon përpara kohe duke u kufizua vetëm në Dukagjin të Shkodrës." 9). Realisht pas çdo lëvizje të brendshme kanë qëndruar faktor të huaj ndërkombëtar, ku përplasja e interesave të këtyre faktorëve është pasqyruar qartë në antagonizmat e lëvizjeve politike të asaj periudhe në Shqipëri. Popullsia e Dukagjinit ishte e besimit katolik, por kategorikisht është e pavërtetuar të aludohet se ajo luftonte për "kryqin", se ajo luftonte të përmbyste Zogun veç se ishte muhamedan dhe pastaj të vendoste një qeveri katolike. Dukagjini kishte qenë pro opozitës antizogiste kishte kontribuar aktivisht në fitoren e Nolit dhe dëbimin e Zogut si inspirues i interesave të çifligarëve, me të cilët Dukagjinin nuk e bashkonte asnjë interes. Gurakuqi, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Avni Rustemi ishin idhujt e vegjëlisë malësore, të cilët Zogu i vrau pas shpine me para, duke i akuzuar herë si serbofil herë si italoofil. Ndokë

Gjeloshi dhe Vas Kiri gëzoni mbështetje dhe reputacion të gjerë popullor në Dukagjin, si patriot (që kohën e Pric Vidit Luftën e Parë botërore, Kongresin e Lushnjës) si fanolist dhe ushtarak. Ata nuk dolën t'u bënte thirrje malësorëve të luftonin për fe, pasi ai nuk ishin aq budallenj sa të mos e dinte se me të tillë parullë nuk bindte as kënd që t'u shkonte nga pas. "Kena ardhë me u ba thirrje me luftue kundër Zogut, me ne është Malësia e Madhe, Puka, Mirdita, Postriba, Gashi, Krasniqja dhe për këtë punë është lidhë besa të luftojmë së bashku për të sjellë në fuqi Fan Nolin edhe një herë.- Kështu janë shprehë Ndokë Gjeloşi Vas Kiri gjithkund nëpër Dukagjin, krahine më krahinë". 10

Janë dy gjëra krejt të ndryshme t'u thuash njerëzve të luftojnë për kryq e për fe dhe t'u thuash të luftojmë kundër tradhtarit Zog, për demokartin Nol. Të thuash se Ndokë Gjeloşi e Vas Kiri nuk janë treguar shumë të sinqertë e aq më tepër Dom Loro Caka është plotësisht e vërtetë, madje nuk është aspak e tepërt që nisma e tyre ishte sa naive aq edhe aventurore. "Ata shkuan shtëpi më shtëpi e katund më katund, qysh nga Qafa e Kolshit deri tek Ura e Shtrenjtë ... ata për këtë siguruan një përkrahje të gjerë të malësorëve, deklaruan se ishin marrë vesh me krahinat e tjera. Dom Loroja bëri be në kryq që më të fillue pushka të gjithë kanë dhënë besën me ia fillue luftës se cila krahinë." 11). Kur Ndokë Gjeloşi e Vas Kiri dolën në Postribë, malësorët i pyetën në emër të kujt e keni fillue këtë punë. Vas Kiri tha: "Ne emër të opozitës e Xhemal Begut" 12). Pra, shihet qartë se organizatorët dinin të shfrytëzonin më së miri ndjenjat antizogiste të malësorëve, të cilët pa përjashtim kishin nostalgji për opozitën e përzënë me kordhë nga Legaliteti dhe pa dallim bindjesh fetare ishin kundër këtij regjimi, ndërsa premtimi i Posribës flet qartë për këtë realitet që me vonë do të manipulohet djallëzisht nga Zogolli. Nën-prefekti i Dukagjinit, Linë Delia i paraqiti Ministrisë së Brendshme, me 12 dhjetor një relacion sipas të cilit kishte bërë hetimet në vend dhe raportonte se: "Kryengritja kishte pas qellim ndryshimin e regjimit, të arratisurit që vinin nga Jugosllavia thanë se kishin përhapë fjalë në popull se kjo lëvizje ishte përgatitur në të gjithë Shqipërinë dhe kryesohej prej Kryetarit të Qeverisë legale Noli, i cili gjendej në arrati dhe se kryengritja do të pëlçiste në një kohë në të gjithë Shqipërinë." 13)

Edhe Musa Juka, dora e hekurt shtypëse e kësaj kryengritje, që mori pjesë jo vetëm në goditjen e lëvizjes rebeluese, por edhe hetimin e saj, i deklaroi Alosit, se "Dom Loro Caka e të tjerë kishin bindur pasuesit e tyre se gjithë Shqipëria e Jugut ishte në revoltë dhe se Tirana kishte rënë në duart e kryengritësve." 14)

Edhe letra e ministrit të jashtëm italian, Alosi e datës 5 janar 1927 drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, si dhe deklarimet e Ministrit të Brendshëm, Musa Juka si hartuesi i relacionit, që i dërgoi Alosit nuk janë fort të besueshme, kanë më tepër karakter politik dhe denigrues, se sa sens vërtetësie. Madje nga ana tjetër Musa Juka, nënprefekti Delia e të tjerë, natyrisht mundoheshin të justifikoheshin ngaqë u zunë krejtësisht të papërgatitur nga kryengritësit, që po të kishin qenë aq të organizuar, siç e përshkruajnë ata, rezultati do të kishte qenë krejt tjetër. Kryengritësit nuk janë manipulua deri në atë shkallë sa ta besonin se ka rënë Tirana dhe ngaqë ra

“Kryeqyteti”, o burra hajde t’i biem edhe ne Shkodrës. Këtë nuk e kanë pranuar asnjëherë as kryengritësit okularë Mark Sadiku, Ndokë Mirashi, Mark Delia, Mark Milani, Babun Celi e sa e sa të tjerë, që asnjëherë nuk i fshinë nga kujtesa ftesën e Gjëlloshit dhe te Vas Kirit, për t’u ngritur në luftë. Qëndrimi aventurist i Ndokë Gjëlloshit dhe Vas Kirit ishte, se megjithëse pa qenë të bindur plotësisht nëse i kishin me vete të gjitha krahinat e tjera, ata në mënyrë naive i besuan Xhemal Begut për Shkodrën, Dodë Nikollës për Malësisë se Madhe. Gjon Marka Gjonit për Mirditën. Sali Mani për Krasniqen, për cilët deklaruan me bindje kudo se “i kemi me vete prandaj sapo t’ia fillojmë ne, janë gati të hidhen në sulm të përgjithshëm. Në gjirin e malësorëve ekzistonte pakënaqësia dhe papajtueshmëria e thellë me regjimin e Zogut, prandaj Ndokë Gjëlloshi e Vas Kiri e të tjerë nuk bënë gjë tjetër veçse i dhanë shkëndija kësaj revolte, që ekzistonte në shpirtat e trazuar të dukagjinave, u vunë në drejtim të kësaj lëvizje dhe e udhëhoqën atë drejt disfatës, disfatë që pati pasoja fatale dhe me një kosto shumë të lartë jetësh njerëzore.

PLANI USHTARAK I KRYENGRITJES

Kryengritësit kishin një plan veprimesh ushtarake:

- 1- Dukagjini, Malësia e Madhe dhe Pos-triba, do të sulmonin Shkodrën;
- 2- Shtatë bajraquet e Pukës, do t’i drejto-heshin Bushatit
- 3- Forcat e Krasniqes dhe Malësisë së Gjakovës, nën kryesinë e Sali Mani, do të Sulmonin Krumën e Kukësin dhe pastaj në Drejtim Lumë - Kala e Dodës - Peshkopi për të marshuar drejt Tiranës.

4- Mirdita, me forcat e saja të armatosura të mos linte kalimin nëpër Mirditë të ndonjë fuqie zogiste, lumjane ose dibrane të drejtuar për në Pukë, për tu vu pas shpine forcave revolucionare të 7 bajrakëve

5- Kur të merrej vesh se Sali Mani kishte mbërritur në Peshkopi, atëherë forcat e Mirditës nën komandën e Gjon Marka Gjonit do ti drejtoheshin Lezhës dhe Milotit. 15)

Kjo lëvizje është quajtur e iniciuar nga jugosllavët, të këtij mendimi kanë qenë edhe diplomatët amerikanë në Tiranë të kësaj Periudhe. 16) Historiografia komuniste e së shkuarës i ka akuzuar organizatorët si tradhtarë të lëvizjes që e iniciuan vetë. Të njëjtën gjë artikulojnë duke ngritur zërin deri në kupë të qiellit edhe studiuesit filozogistë sot.

Atëherë lind pyetja vetvetiu:

-Po Zogolli ç’ është ?

Pasi dihet se edhe ai erdhi në pushtet me ndihmën e pakursyer të jugosllavëve. “Ata i vunë në dispozicion një falangë prej 1000 trupash të rregullt të ushtrisë jugosllave, 800 ushtarë e 40 oficerë të bardhë Rusie” 17).

Në qoftë se bëjmë një paralelizëm historik mes këtyre dy ngjarjeve. Lëvizja e Dukagjinit nuk pati asnjë forcë të huaj ndihmëtare siç bëri Zogu, me ushtarët jugosllav, të cilët për t’i maskuar i veshi me uniforma shqiptarësh . “Kryengritësit s’ kanë pas asnjë pushkë, asnjë fishek të huaj , pasi ka qenë e pamundur me ia fsheh atij regjimi tradhtar e për ta përdorë kundra tij. Lufta e tyre ka qenë një vepër dëshpërimi thjeshtë patriotike e antif feudale" 18). Ajo që duhet nënvizuar është se, shkëndija e shpërthimit dhe krejt rrjedhoja e kësaj lëvizje erdhi prej vetë shqiptarëve dhe kjo vërtetohet qartë pasi në ato momente as Roma, as Beogradi nuk dëshironin rrëzimin e Zogut. Kryengritësit nuk donin t’ia dinin dhe kjo ndoshta ishte një nga gabimet e tyre disfatike. Malësorët e rebelosur kërkonin përmbyshjen definitive të regjimit të Zogut, pavarësisht nga rruga aventureske që kishin zgjedhur prijësit e tyre. Madje edhe Gjëlloshi, Kiri, Miraka e Kosova ka mundësi se nuk dinin intrigën politike se qoftë jugosllavët, qoftë italianët nuk donin të ndryshonin statukuonë politike në Shqipëri, apo thjeshtë në rastin konkret këtë revoltë do ta përdornin si mjet presioni ndaj dredharakut Ahmet. Pa dashur që të behëm fare avokat i

tyre, unë do nënvizoi se malësorët mërzitur me Zogun nuk mund të dinin gjë për prapaskenat e politikës se madhe që luanin fqinjët në kurrizin e vendit tonë, pasi normalisht për vetë temperamentin e tyre zor se do pranonin të hynin në një lojë që ishte planifikuar të dështonte qysh pa filluar akoma dhe që do ta paguanin shumë shtrenjtë. Dom Loro Caka ka qenë udhëheqësi dhe organizatori politik i kësaj lëvizje. Dy nga enigmat më të mëdha të kësaj lëvizje janë:

Së pari, përse Dom Loro Caka kaloi kufirin me 11 nëntor 1926 , pa u këshilluar fare me Mustafa Krujën, me të cilin ishte në lidhje, madje për këtë veprim nuk ka informuar fare as drejtuesit e veprimeve luftarake të terrenit, Ndokë Gjëlloshin e Kolë Bibë Mirakën?

Së dyti, përse ai dha urdhër të prerë që lëvizja të fillonte përpara kohe, e cila mbeti e lokalizuar vetëm në Dukagjin dhe jo në gjithë Shqipërinë veriore siç ishte plani?

Këto pikëpyetje i kanë bërë disa studiues ta akuzojnë hapur Cakën si i vënë në shërbim të Jugosllavëve, që luftonte për kantonizimin e Shqipërisë të ndarë sipas kriterëve fetare. Në lidhje me këtë ngjarje Spiro Kosova na e konfirmon se plani i kryengritjes parashikonte kryengritja të fillonte më parë nga jugu dhe me 28 nëntor edhe nga veriu, mirë po puna ngjau ndryshe. “Kur gjendesha në Apripë të papritmas nga Dukagjini prej Komandës së Përgjithshme të revolucionit erdhi urdhri 317/11, datë 17 nëntor 1926:-Komanda nga burime të besueshme mori informata të sig-urta se Zogu po përgatitë një operacion për në Dukagjin, nga ana e Shkodrës, nën komande e Fiqiri Dinës dhe nga ana e Lumes nën komandën e Muharrem Bajraktarit.”19) Sipas këtij urdhri kryengritja do të fillonte jo me 28 nëntor, por në mëngjesin e datës 20 nëntor 1926. Gjithashtu urdhëroheshin toger Spiro Kosova që sipas urdhrit të Kapiten Kolë Bibës, t’u prijë forcave të armatosura. “Ky urdhër është i premtuem dhe pritët zbatim me çdo sakrificë. Nënshkrimi Dom Loro Caka, Dukagjin 17 nëntor 1926”20).

Në zbatim të urdhrave të komandës Eprore, Toger Spiro Kosova nisi lajmëtarët e tij të besuar për të njoftuar Kolë Bibën që gjendej në Kosove që të kthehej sa më par së bashku me Sali Manin e Krasniqes. Njëkohësisht u lajmërua edhe Gjon Marka Gjoni i Oroshit, duke i venë në dijeni për ndryshimin e datës së fillimit të kryengritjes nga të gjitha viset e Dukagjinit, në 7 bajraquet e Pukës e në Mirditë dhe nga Krasniqja deri në Has, në kufij me Lumen. Sipas marrëveshjes dhe planit paraprak të veprimeve Kapedani i Mirditës Gjon Marka Gjoni kishte për detyrë të përballonte forcat kundërshtarë zogiste të ardhura nga Luma në drejtim të Pukës.

LËVIZJA DUKAGJINIT DHE PRAPASKENAT ITALO –JUGUSLLAVE

Kryengritja e planëzuar dhe besëlidhur të fillonte kudo njëherazi filloi vetëm në Dukagjin dhe në Pukë Sipas dëshmiave të Spiro Kosovës, krahina e Tropojës “nuk mori pjesë ne kryengritje sepse Jugosllavia sapo mësoi për kryengritjen internoi Sali Manin e Krasniqes.”21) Ky citim i zotit Kosova na çon drejt arsyetimit se jugosllavët nga njëra anë i nxitën krerët të fillonin luftën dhe nga ana tjetër i frenuan nga prapaskena ngaqë nuk donin përmbyshjen e Zogollit, që kishin investuar për ta risjellë në skenë. Faktori ynë i brendshëm u tradhtua, si shpesh herë të tjera, nga faktorët e jashtëm. Kjo lëvizje është produkt dhe viktimë e konjukturave imorale italo-jugosllave, që akoma mbajnë në vetë-vete një mister të pandriçuar mirë aq sa edhe historia jonë akoma nuk e ka thënë plotësisht fjalën e saj për këtë ngjarje të koklavitur. Akoma sot e kësaj dite nuk zotërojmë dokumente të përpikta, të cilat do të provonin në mënyrë të padiskutueshme fajësinë materiale jugosllave. Nuk kishte dyshim, konkludonte ministri italian në Durrës, se përgjegjësia e gjithë këtyre ngjarjeve binte mbi autoritet jugosllave. 22) Pohimi i Alosit nuk mund të marrë vlerat e së vërtetës, pasi

ai zyrtarisht ishte përfaqësuesi i Italisë, shtetit që akuzohej nga Beogradi. Nga ana tjetër shtypi jugosllav ngarkonte Nolin (tani në Vjenë) që kishte pasur gjoja ndikimin e Italisë. 23) J. Swire thotë se çdo vëzhgues anglez ishte në pozitë për të gjykuar, se cila është e vërteta: “implikimi i Jugosllavisë ishte jashtë çdo dyshimi”. Pohimi shpeshherë shabllon se autoritet jugosllave kanë qenë nxitësit kryesor të kryengritjes nuk përjashton fare akuzën, se edhe italianët kanë dhënë kontributin e tyre të vyer. Nuk mund të përjashtohet mendimi se Roma ka qenë në dijeni për përgatitjen e kryengritjes dhe ka qëndruar pasive duke i lënë ngjarjet të rrrokullisën, duke i kontrolluar nga larg duke mos e informuar Zogun me qëllimin djallëzor që në një moment të gjykohej i përshtatshëm të dilte në skenë dhe të arrinte synimet e saj. Historiani Xh. Zamboni i duket e pabesueshme që Kryengritja e Dukagjinit të ketë shpërthyer fare pa dijeninë dhe përkrahjen e Italisë. 24) Historiani jonë i mirënjohur Paskal Milo duke analizuar dokumentet me origjinë italiane ka arritur në konkluzionin se Roma ndiqte me përparësi veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar jo vetëm në Itali, por edhe në Jugosllavi, dhe nga radhët e këtij emigracioni kishte rekrutuar në favor të shërbimit të vet... 25) Që nga vera e viti 1926 Italia kishte të gjitha informacionet e sakta për përgatitjen e Kryengritjes së Shqipërisë së Veriut. Nisur nga këto informacione Musolini i shqetësuar, me 24 tetor 1926 i shkruante Legatës Italiane të Durrësit se, në qoftë se situata është kaq e rëndë sikur tregohet, qeveria mbretërore duhet të eliminojmë politikën e saj ose për të ndihmuar me çdo kusht Ahmet Zogun, ose për të evituar ardhjen në fuqi të një qeverie të re në Shqipëri... 26) Alosi i sugjeroi superiorit të tij të gjithëpushtetshëm, se duhej pritur disa ditë pa hyrë në kontakte të ngushta me refugjat, se midis tyre nuk dallonte “ndonjë njeri në vijën tonë dhe mjaft të fortë”, se “Zogu e mban vendin nën regjim të hekurt, nën të cilin opozita e ka vështirë të bashkohet e të mbështetet nga jashtë”. Në qoftë se Zogu - vazhdonte Alosi, - do të bashkohet me pikëpamjen tonë, ai nevojitet të mbështetet mirë, sepse është njeriu i vetëm i grushtit, që mund të qeverisë Shqipërinë.

“Ose me zogun ose me të tjetër, politika jonë në Shqipëri nuk mund të mbështetet veçse me veprimin e forcës dhe të parasë ... 27) Pra qeveria italiane nuk e sinjalizoi Zogun për përgatitjen e Kryengritjes:

Së pari , nuk dëshironte ta bënte një gjë të tillë ...;

Së dyti , ishte vetë e implikuar në marrëdhënie e komprometuese me kundërshtarët politik të Zogut në emigracion;

Së treti, donte të përfitonte nga vështirësitë që mund t’i krijoheshin Zogollit për t’i imponuar atij nënshtrimin e traktatit politik.

Në komplotin e intrigave italo-jugosllave, Italia doli më e fituara dhe më e “pastra”, pasi udhëheqësit e kësaj lëvizje ishin të arratisur politik, që kryesisht vepronin në Jugosllavi dhe pikërisht nga toka jugosllave kaluan kufirin dhe u vunë në krye të kryengritësve malësorë dhe që ka të gjitha gjasat të jenë instruktuar nga italianët të vepronin kështu, që kjo vepër tu mbetej e gjitha tek dera jugosllavëve.

“Italianët shfrytëzuan me sukses këtë rivalitet, duke i bërë presion Zogut të nënshkruante Paktin e Tiranës. Ata në atë moment nuk do të pranonin kursesi përmbyshjen e tij po të mbajmë parasysh kohën dhe energjitë që kishin shpenzuar për të ... 28) Kryengritja e Dukagjinit u shfrytëzua nga Roma në dobi të vet, kurse Beogradi doli i humbur dhe mbeti i pambuluar si nxitësi kryesor i saj.

Kryengritja e Dukagjinit është një ngjarje historike komplekse e pandriçuar plotësisht, e cila vazhdon të jetë e hapur për studiuesit në të gjitha aspektet dhe sidomos për sa i përket rolit dhe ndërhyrjes së faktorit të jashtëm për shpërthimin e saj. Gjithsesi një gjë është më se e sigurt, se pavarësisht nga shkalla e kontradiktave mes Jugosllavisë dhe Italisë, këto

dy shtete ishin përgjegjëse për shpërthimin e saj dhe secila sipas interesit të vet strategjik kontribuoi në shpërthimin e saj, pasi kishin studiuar mirë truallin e përshtatshëm të pakënaqësisë së popullsisë së Shqipërisë së Veriut ndaj pushtetit të Zogut. Nëse nuk pajtohem me mendimin tejet ekstrem, se kjo lëvizje ishte thjeshtë separatiste e krishterë kundër presidentit dhe qeverisë qendrore muhamedane, nuk mund të mohohet fare se kleri katolik dhe priftërinjtë françeskan të Shkodrës ishin në opozicion të hapur kundër Zogut dhe qeverisë së tij, veprimtari që kishte çuar deri në arrestimin e tyre (një nga ata ka qenë P. Anton Arapi) nga ana e regjimit Zogist. Nuk mund të mohohet se françeskanët e Shkodrës me anë të idhullit të tyre, Gjergj Fishta kanë kontaktuar me ministrin e jashtëm jugosllav në Tiranë. 29) Në prag të fillimit të kryengritjes, policisë zogiste i kanë rënë në dorë tre letra, një që i drejtohej Sadri Lukës së Thethit dhe meshkujve të tij nga disa të aratisur politik në Podgoricë, në të cilën i tregohet dita se kur do të futeshin në Theth. Letra e dytë, natyrisht më e rëndësishme, e cila mban datën 17. 03. 1926 dhe i drejtohej Patër Anton Harapit, emri i dërguesit kishte pseudonimin “Toma” dhe në të pasqyrohej mënyra e koordinimit të veprimeve në Malësinë e Madhe, Dukagjin e Shkodër për rrëzimin e qeverisë. “Po të bajmë me dije edhe ty se xhevapin e shpërndamë në malet që janë krye të Shkodrës, tujë u dhanë xhevapin për një punë që dinë vetë. Epja xhevapin Shkodrës ... Për me ja fillue te tanë përnjheri ... Në 5 sahati do kemi hy në Rrëzë të Veleçikut, kena me ra në Shkrel e kena me hy në Shalë, atëherë kena me dhanë xhevapin me ia nisë pushkën përnjheri ...”.30) Letra e tretë i drejtohej Mark Lukës në Malësi të Madhe. Emëruesi i përbashkët i këtyre letrave është njoftimi nga ana e organizatorëve i fillimit të Kryengritjes dhe sigurimin e mbështetjes nga këto treva. Kjo letër mjaft komprometuese u dha shkas autoriteteve policore që P. Anton Arapi të merrej në hetim, mbasi u kompozuan procedurat e duhura ... 31). Procesi i hetimit ndaj Pader Antonit nuk do të nxirrte as gjë në dritë për policinë, e cila në telegramin e datës 01. 04. 1926 njoftonte Ministrinë e Brendshme në Tiranë se; “Prej Pader Antonit nuk kemi kurrëgjia, ai gjindet nan vërejtje”, ndërkohë që nga lart ju dha urdhër Koplikut të kontrollohet shtëpia e Mark Lukës. 32). Për shpërthimin e kryengritjes jo vetëm kishte dijeni kupola më e lartë e klerit katolik të Shkodrës, por ishin direkt të interesuar dhe nxitës të saj (pasi Zogu në reformat që po ndërmernte ishte për një shtet laicist të ndarë dhe të pavarur nga besimet fetare) . Dom Lora Caka ka të gjitha gjasat të ketë marrë bekimin e kësaj kupole, fijet e së cilës nuk dihet se ku të shpien më parë tek jugosllavet apo italianët, kurse Gjëlloshi, Kiri, Miraka, Kosova me kompani ishin thjeshtë instrumente për arritjen e qëllimit nga padronët e vet, por gjithsesi naviteti dhe aventura e tyre mbetet e pafalshme dhe historikisht e dënueshme. Rol parësor në ngritjen në këmbë të fuqisë kryengritëse(60 % të pa armatosur e kanë luajtur bajraktarët e Dukagjinit, veçanërisht Lush Prela dhe Lulash Gjëlloshi, të pakënaqur nga politikat centralizuese të Zogut në dem të pushtetit të bajraktarëve në tërësi. Kleri katolik dhe bajraktarët me pushtetin e tyre absolut mbi masat malësore, totalisht analfabete, janë nxitësit dhe motivuesit e drejtpërdrejtë të dukagjinave, qoftë në kryengritjen antizogiste të vitit 1926, qoftë në rezistencën e Qafës së Kolçit në vitin 1945 dhe veprimeve të tjera sporadike të organizuara mjerisht kundër komunizmit në vitet e para pas çlirimit, ngjarje që patën pasojat tragjike për fatin e dukagjinave, të cilët u panë si mace e zezë qoftë nga zogistët, qoftë nga komunistët.

Prele Milani

DOKTORI QË U NDERUA ME BUSTE E DEKORIME

- KUJTIME NGA SHOKU I BANKËS -

Ishte 1 shtatori i vitit 1972, plot 44 vjet më parë, sapo fillova mësimet në shkollën e mesme Mjekësore në Shkodër, dega Stomatologji. Fati e deshi që profesoresha ku-jdestare Myzejen Cufi (Çanga), njëkohësisht Drejtoreshë e Shkollës, më caktoi në bankën e parë me Prelë Gjelošin. Dua të theksoj një veçori të tij, që nga ajo ditë asnjëherë nuk më rastisi të takoj një nxënës apo student kaq të devotshëm dhe të përkushtuar në procesin mësimor. Gjatë mësimit apo kohës së studimit ishte aq i vëmendshëm saqë nuk mund ta hiqje nga teksti, qoftë edhe duke e tundur me forcë. “Culi”, vazhdonte punën e tij, në të tijën sikurse Luli i vocërr. Këtë epitete ia kishim vënë duke marrë shkas nga ky personazh Migjenian. Megjithëse nga rrethe të ndryshme kishim një shoqëri sikur të ishim të një barku.

Pak kohe më pare, Hasie Tola na bashkoi në Tirane, në përvjetorin e maturës. Ne, të grupit të Shkodrës, Paulini, Njaci, Sadiku e Veseli, nuk na mungoi as Dr. Prela, sepse për te u fol gjatë.

Degën e sapofilluar e kishte ëndërruar që në vegjëli për t’i shërbyer me përkushtim dhe devocion si i pari dentist, vendlindjes së tij, Dukagjinit. Megjithëse me rezultatet e shkëlqyera sapo mbaroi semestri i parë i vitit të dytë, fati në kundërshtim me dëshirën e tij dhe gjithë përpjekjen e Drejtorisë së Shkollës, deshi që ai të mobilizohet ushtar. Kryente detyrat si ushtar gjithnjë shembullor në Patos dhe për asnjë çast nuk iu nda libave duke studiuar në mënyrë ilegale. Librat ia dërgoja rregullisht nëpërmjet dajës së tij, Shanit, që asokohe banonte në lagjen Tre Heronjtë. Nga letërkëmbimet më tregonte se me çfarë devotshmërie përgatitej në mënyrë autodidakte për t’u kthyer bankave të shkollës sa më i përgatitur. Përsëri fati nuk e deshi që ai të vazhdonte degën e ndërprerë, sepse stomatologjia u mbyll. Detyrohet të vazhdojë degën e Infermierisë, të cilën e mbaroi shkëlqyeshëm. Dëshira e tij tani realizohet duke filluar Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës, në vitin 1979. Përkushtimi dhe ambicia e tij për të ndjekur rrugën e disa mjekëve dukagjinas, të cilët i adhuronte, bënë që studenti Prelë Gjeloši të përfundonte fakultetin me rezultate maksimale, në vitin 1984. Tani nga fakulteti nuk doli thjeshtë një mjek i përkushtuar dhe i etur për dije bashkëkohore, por edhe një djalosh me virtytet më të larta të malësorit duke trashëguar nga geni i familjes, fisnikërinë. Tani studenti i shkëlqyer më se njerëzor, këmbëngulës, korrekt dhe i gatshëm për të dhënë gjithçka nga vetja në shërbim të atyre që kishin nevojë, këto tipare spikatnin personalitetin e tij të porsaformuar. Punën e fillon në vjeshtën e vitit 1984 në vendlindje, ishte privilegji i tij, që të punojë me mjekë shumë të njohur si: prof. dr. Ylli Ziçishti, dr. Zyhdi Çoba dhe dr. Bashkim Bala.

Në vitin 1998 caktohet në zonën e Jubanit dhe pas një viti, pas një pune të mirëvlerësuar caktohet pranë DRSKSH në Shkodër, në sektorin e mjekut të familjes, ndërsa në vitin 1999 caktohet në Grudë të Re duke qenë njëkohësisht edhe pedagog në Fakultetin e Infermierisë.

Dr. Prela prej vitesh ka qenë ndër dre-

jtuesit e Kryqit të Kuq në Shkodër. Në vitin 2004 e gjejmë si drejtues i qendrës shëndetësore të Komunës Rrethina.

Në sajë të përkushtimit, profesionalizmit dhe pasionit të pasioq krijoi kudo tek pacientët një besim të admirueshëm duke mos pasur mundësinë e krahasimit. Vërtetë nuk pati luksin dhe mikun për tu specializuar në një degë të veçantë të mjekësisë ndonëse rezultatet në fakultet dhe gjatë punës bënë diferencë të paarrtshme nga të tjerët, por ndoshta kjo ndikoi për të mirë nga ana profesionale, sepse u vetëspecializua nga studimi i pareshtur dhe puna me përkushtim. Të gjitha këto bënë që të tejkalonte edhe specializimet, që më shpesh “dhuroheshin”, sesa

dhe njëkohësisht autor i këtij shkrimi (M. Bobnaj), duke e veçuar nga ish nxënësit ndër të tjera citon: “Për ndjenjat dhe veprimtarinë e tij humane zona e Dukagjinit dhe e Rrethina dr. Prelën e konsideronin si Misionar të Nënë Terezës”. Ky njeri i palodhur ka kontribuar me devotshmëri pranë Caritasit gjatë luftës në Kosovë, duke dhënë një kontribut të vyer. Ishin para dhe tetraplegjikët kategoria e pacientëve për të cilët kujdesej me një përkushtim të veçantë duke bashkëpunuar me shoqatën e tyre. Ishte dr. Prela shembulli i kontributit gjatë përmbajtjeve në zonën e Shkodrës. Për këto veprimtari të veçanta dhe shumë të tjera përveç vlerësimeve nga të afërmit, shokët, kolegët e veçanërisht pacientët



Dr.Ndoci Shtëpia, Prel Martin, Mark Bobnaj

fitoheshin. Dr. Prela nga viti 1998 deri në vitin 2012 ndoqi 16 trajnime dhe kurse formimi profesional në vijimësi, kryesisht në sektorin e Mjekut të Familjes.

Në vitit 1998 nga UNICEF u trajnuar si Mjek i Familjes; në vitin 2000 trajnohet për planifikimin familjar; në 2006-ën trajnohet nga specialistet Amerikanë dhe të Ministrisë së Shëndetësisë si mjek i familjes; po në vitin 2006 trajnohet për parandalimin e Astmës; trajnim për infeksionet Respiratorë në 2006; po në vitin 2006 trajnohet për menaxhim dhe financim të Pendrave; në vitin 2008 trajnim Social Health Insurance; me 1999 një zhvillim profesional të përgjithshëm; në vitin 2010 trajnohet për Teknologjinë e Kontraceptivëve; po në vitin 2010 u trajnuar për Shërbim Shëndetësor Parësor; përsëri në vitin 2010 në vlerësimin e aftësive të kufizuara në Shqipëri; trajnim të para dhe tetraplegjikëve në vitin 2010; në vitin 2011 trajnuar në Palliative Case Course; përsëri këtë vit trajnohet për kujdesin e të sëmurëve me Cancer; sërish në 2011 trajnohet për mjekësi të përgjithshme në “Transformim”; në vitin 2012 trajnohet për sëmundjet “Pulmonare Kronike”.

Duke qenë model i paarrtshëm i përkushtimit e korrektësisë tek doktori mbi gjithçka triumfonte humanizmi i pasioq. Në historikun e shkollës së mesme Mjekësore në Shkodër shkruar nga ish nxënësi i kësaj shkolle

të cilëve iu gjet pranë, tek të gjithë këta ishte një vlerësim i përbashkët, krenari, vlerësim i pasioq edhe për thjeshtësinë e komunikimit nga ku rrjedhtë respekti dhe vlerësimi i veçantë. Dr. Prelën vitet e pluralizmit e gjetën dhe ai i përcolli pa e konsideruar shërbimin shëndetësor si mundësi përfitimit material duke mbajtur kështu të shenjtë betimin e Sokratit.

Gjatë bisedave më tregonte për përpjekjet dhe ndihmesën për të diagnostikuar dhe ndihmuar pacientët për tu mjekuar me efikasitet dhe me kosto sa më të ulët. Është e pamundur të flasësh për vlerat e tij të veçanta dhe të mos përmendësh shokun e tij të fëmijërisë, kolegun, bashkëpunëtorin e ngushtë dr. Ndoci Shtëpia, këta kishin thuar se të gjitha vetitë e larta njerëzore e humane aq sa ngjasonin si vëllezërit Sinamezë. Dr. Ndoci kishte mbaruar Fakultetin e Mjekësisë me rezultate, të cilat nuk qenë përsëritur nga askush prej dekadash. Me dr. Ndoci në pata fatin të punoja për vite me radhë në zonën e Shoshit në kushte jetese dhe pune jonjerëzore, ushqimin dhe bukën e grurit i merrnin nga shtëpia, shumicës e të cilës e ndante me fëmijët e vegjël dhe flinin në një shtrat tek prej druri. Thujse çdo javë vinte në Shkodër dhe nga xhepi i tij blinte ilaçet e domosdoshme për pacientët. Udhëtonte natën në shi e në borë për në Toplanën e largët e Gurin e Lekës, improvizonte

“reanimacionin” në kushte shtëpie. Jo vetëm që i mjekonte me ilaçet e tij, por pacientëve iu linte parë për të vazhduar mjekimin. Kur u caktua që të mbulonte me shërbim edhe zonën e Sumës tashmë puna u bë e papërballueshme, kjo distancë mund të përshkohej vetëm me helikopter. Paga nuk mjaftonte as për udhëtim, të ardhurat e familjes të papërballueshme për jetesën. Nga kushtet e krijuara më shpreh mendimin për të marrë një aventurë vetësakrifikuese, ide të cilën e refuzova pikërisht për pasojat e rrezikshme që mbante. Megjithatë ia doli, por përsëri dëshpërim në kampin famëkeq deri çnjerëzor në ish Jugosllavi. Ruaj edhe sot ato letra plot pesimizëm që mi dërgonte ku shumë gjëra unë i kisha parashikuar me kohë. “Isha i etur për drejtësi e demokraci, por nuk ekzistuan në botë” – më shkruante, kur nuk po kapte Amerikën e ëndërruar. Me të mbërritur përtej oqeanit ku puna është e para, dr. Ndoci ndonëse punon shofer kamioni në sajë të këmbënguljes Titanike studion deri në kufijtë e të pamundurës duke arritur të bëhet edhe drejtues i një spitali prestigjioz në New York.

Ai la mbresa të pashlyera në të gjithë Dukagjinin në botimin voluminoz të Doktorit të Shkencave, Zef Gjeta, në librin “Dukagjini”, dr. Ndoci është radhitur ndër figurat më të spikatura të Dukagjinit. Për aftësitë e tij profesionale dhe kontributin human në shkallën më superiore, siç ishte natyra e tij, ai bëri gjithçka të mundur për t’i ardhur në ndihmë shëndetit të rënduar të dr. Prelës, së bashku me kolegët e tij amerikanë ku ai punon.

Këta dy shokë e kolegë përbënin duetin më të spikatur të brezit të ri të doktorëve Dukagjinas. Zoti e dhëntë sikur këta të bëhet edhe një i tretë ... Ata vazhduan rrugën e paraardhësve të tyre të trullit Dukagjinas, Doktorët e Shkencave Zef Delia, Vuksan Kola, Ndoci Çardaku dhe mjekëve të nderuar Sokol Mjeda, Pal e Fran Kapaj, Dritan Mrapshtija.

Tek personalitetet e spikatura nuk mjafton të përshkruhen me një biografi ose me pak radhë si ky shkrimi im, por vepra e tyre në dobi të shoqërisë siç ishte dr. Prela, një bir i devotshëm i zonës, ku u lind do të lënë mbresa të pashlyera. Ai punoi, kontribui me shpirt e zemër si profesionist me mendjen e ndritur që pati dhe si i tillë ai do të jetojë pa fundësisht në kujtesën e të gjithë atyre që e njohën. Njerëz të tillë është nder ti kujtoshe aq më tepër kur i kujton shokë të klasës e të bankës. Është një kujtim i bukur për çdo bashkëmoshatar i afërm, shok, koleg dhe në veçanti pacientë, të cilët kanë qenë pjesë e fjalëve të tij dashamirëse, këshillimeve të këtij njeriu të mirë dhe mjeku human.

Ai ishte simbol i thjeshtësisë i gojës së ëmbël, i sinqeritetit e fjalëpakë dhe si afërt tek gjithsecili depërtonte në ndjenjat e pacientëve duke iu përcaktuar më me lehtësi diagnozën dhe përpara medikamenteve, ai e bënte mjekimin më efikas. Dr. Prelën e njihnin dhe shumë nga ata që nuk e kishin takuar ndonjëherë, e njihnin nëpërmes punës dhe fjalës së mirë. Tek po bisedoja me një grup gazetarësh televizionit për t’i kushtuar një emision, sapo ua prezantova më befasoi

gatishmëria duke folur me superlativa për doktorin, të cilin kurrë nuk e kishin takuar, por e kishin të shumë dëgjuar. Dr. Prelën nuk e respektuan vetëm dukagjinasi, mjedasorët dhe banorët e Rrethinave e të Shkodrës, por të vegjël e të moshuar. Ai mori pjesë në gëzimet, hidhërimet, sëmundjet e atyre që kishin humbur shpresën e jetës, ai i inkurajonte si askush tjetër. Për këto dhe shumë merita të tjera Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me urdhrin Naim Frashri te Kl i II.

Në ditët e lamtumirës ky humanist dhe zemërmirë edhe çastet e fundit i kaloi duke ndarë me të gjithë gëzimet familjare e në veçanti afeksinonin që kishte për nënë Lulen e moshuar. Kujton vitet e fëmijërisë, këshillat e babës Martin, shoqërinë e ngushtë me

vëllezërit Dodën e Lulashin dhe nusët e tyre, dashurinë e pakufishme për motrat e në veçanti për nipat dhe mbesat. Ky humanist i një specie të veçantë frymëzonte dhe inkurajonte në çdo çast Marien, ëndërronte deri në pafundësi për mirëvajtjen e Klodit dhe Benardit, të cilët tashmë ishin duke kaluar në profesionit të tij. Shëndeti megjithëse rëndohej ai ishte më tepër i interesuar që të gjithë t'i inkurajonte që t'ua lehtësonte atyre dhimbjen, të cilën vetë po kalonte, edhe në këto kushte shpërthente shpirti i tij më se human. Ai kërkonte që në çdo kohë e ambient pa pyetur për gjendjen e vet të mbizotëronte gëzimi dhe të gjithë i uronte nga thellësia e shpirtit.

Gjurmët që la pas janë të pashlyeshme, këtë e ka vërtetuar në mënyrën më kuptim-

plotë nderimi dhe respekti i treguar këto katër vitet që është larguar fizikisht nga ne. Ceremonia e përcjelljes së tij ishte disi e veçantë për nga mënyra e organizimit dhe pjesëmarrjes, duke se në këtë lamtumirë mernte pjesë e gjithë Shkodra e përbotur. Kishte lindur me 19 tetor dhe po në këtë datë të muajit tetor iu bë nderimi I madh. Nderimi për doktorin nuk njeh kufi, zonat ku ai kontribuoi e shpallën qytetar nderi të tyre. Qendra Shëndetësore e Grudës së Re është pagëzuar me emrin e tij. Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" e ka nderuar me titullin e lartë "Anëtar i Nderi i Shoqatës".

Tashmë pacientët sapo futen në oborrin e këtij institucioni përpara iu shfaqet doktori me uniformë dhe stetoskop në qafë dhe i

buzëqeshur si më parë, tani jo për t'i vizituar, por ata shkojnë për ta përkujtuar, Është busti madhështor i ngritur në përjetësimin e punës dhe veprës së tij. Në shenjë respekti e përjetësimi janë skalitur vargjet drithëruese të rapsodëve Dukagjinasi, të cilët duke i dëgjuar sikur edhe malet detyrohen të lotojnë.

Jeta vazhdon, brezat ecin, Klodi e Benardi, dy djemtë e tij të laureuar për mjekësi kontribuojnë në Napoli e Firenze. Janë doktorët e doktorit, janë produkti dhe kontributi i tij dhe i Maries, janë realizimi i ëndrrave dhe i dëshirave të tyre, të cilat u bënë realitet.

Respekt të përjetshëm shokut të bankës dhe kolegut të paharruar!

Mark Bobnaj

Shkodra në veprën studimore të Agron Lukës

Me datën 12 nëntor 2016, ne mjediset e Bibliotekës "Marin Barleti" u zhvillua ceremonia e paraqitjes së librit shkencor "ΣΚΟΔΡΙΝΩΝ", me autor studiuesin shkencor, Agron Luka.

Morën pjesë shume studiues profesor dr. Tomorr Osmani, Kryetari i shoqatës së Shkrimtareve Shkodër, poeti Skënder Temali, konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, Gjergj Leqeja, Mjeshtri i Madh, Ahmet Osja, anëtar i këshillit të Bashkisë Shkodër, Filip Guraziu, e të tjerë.

Vërtetë një pune të madhe studimore e shkencore mbi Shkodrën tone ne shekuj ...

Një organizim e përgatitje shume serioze e Drejtorit të bibliotekës "Marin Barleti", Gjovalin Çuni, i cili pasi ky, hapi takimin me një fjale shume serioze, i dha fjalën studiuesit, Eduard Grisha.

Dhanë opinione:

Skulptori Fred Kola, qe ne mes te tjerave u shpreh: *"Respekt e mirënjohje si shkodrani-shkodranit, si shqiptari-shqiptarit, qe shume dashuri dhe përkushtimit, me një pune te palodhur dhe te pa shoqe, na ke dhen enje material te vlerite dhe shume te cmuar. Ky material i hulumtuar dhe i nxjerre nga thellësia e kohës, nga gjerësia gjeografike qe dedikohet popullit te tij, ne mënyrë te veçante specialisteve te fushave përkatëse për tu thelluar dhe për te hedh drite ne te vërtetat historike te çështjes tone lokale dhe kombëtare, edhe me gjere.*

Ky studim me frymëzoj se shpejti te paraqes një bocet për Mbretin Gentin dhe, një barazreliev te një monedhe antike ...

Urime edhe një here dhe u realizofshin ëndrrat dhe dëshirat tua,ja, i nderuar Miku im!"

Av. Bardhy Lohja, Pedagogu i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Qamil Gjyzezi, Studiuesi Ismajl Bala Profesor Gjergj Perluca.

Fjala e studiuesit Eduard Grishaj:

Libri i Agron Lukës, Skodrinon, vjen për lexuesit në një moment kur në tërësi kultura jonë po prodhon kryesisht shkrime të ngutshme, të paplota në aspektin argumentues e shpesh pa aparat bindës shkencor, si për të na kujtuar që temat e rëndësishme kërkojnë kohën e duhur dhe seriozitetin maksimal.

Libri përmbledh disa studime të zgjedhura autorit, të botuara me shkurtime në periudhën e vendit, të cilat përfshijnë një periudhë

mjaft të gjerë me hulumtime në disa fusha që i mbulon albanologjia, por edhe më tej dijet krahasuese në histori, gjuhësi, arkeologji, mitologji, numizmatikë, kulte e rituale antike, heraldikë e folklor.

Pjesën kryesore në libër e zë Shkodra me krye çështjet e saj, etimologjinë e emrit; legjendën arketipore të Rozafës, si mit tokton; Shkodra si qytet-shtet i tipologjisë komunë republikane dhe nën çështjet e lidhura me të (Statutet dhe tregues të tjerë); etimoni i Mazit në toponimin Mazrrek, si fjalë kompozitë e shqipes, gjurmët e një raporti historiko-mitologjik të Shkodrës me Aleksandërin e Madh, por edhe çështje të tjera si interpretimi i emërtimeve të lashta Iliria dhe Adria, miti i themelimit të Durrësit, kulti i gruas ilire, kulti i Nënës së Madhe, miti i vëllezërve trinjakë gerionë, mitologjizmi i venës ilire, apo edhe qasje krahasuese mes të dhënave folklorike dhe atyre historike siç është rasti i baladës së



Lulë Frangut etj.

Autorin e kanë shqetësuar me kohë shmangia, errësira dhe pamjaftueshmëria interpretuese e disa prej këtyre temave nga studiues të mëparshëm. Nga ana tjetër ai tregohet i hapur dhe vlerësues ndaj rezultateve dhe arritjeve të autorëve të mëparshëm, si Gjeçovi, Marin Sirdani, Çabej, apo të dijetarëve me peshë ndërkombëtare si Hahn, Shtadmyler etj. që kanë rendur në të njëjtin sens, atë të zgjidhjes së problemit të autoktonisë së disa legjendave e miteve, për të cilat fqinjët slavojugorë janë në konkurrencë të padrejtë. Disa herë në këtë libër, Luka tërheq vëmendjen e lexuesve kah rëndësia e veprës së Barletit duke i nxitur ta vlerësojnë humanistin tonë jo vetëm për shkallën e gjerë të informacionit që na ka lënë, por edhe për konkluzionet e

sakta, aq më tepër kur në rrethanat e kohës, ky dijetar nuk mund të kishte dhe të konsultonte gjithë literaturën e duhur.

Në shumë raste, këto studime vijnë si shënime kritike ndaj studimeve të mëparshme të autorëve të ndryshëm, të cilat Luka, i gjen me mangësi, apo me konkluzione të gabuara. Në këtë drejtim, ai është shërbyer nga një lexim i thellë i gjithë literaturës, që zë fill që me autorët antikë, për të vazhduar me autorët e kronikave mesjetare e deri në botimet e sotme, e po ashtu ka shfrytëzuar edhe të gjitha lëndën e mundshme arkeologjike. Analiza e tij e studimore e shqyrtimeve, arritjeve apo edhe gabimeve është shtruesë dhe citimet janë tërësisht korrekte. Vlen të thuhet se shqyrtimi i konkluzioneve të dijetarëve të mëdhenj është bërë me përgjegjësi të lartë shkencore.

Libri është i paraprirë edhe nga dy parathënie që përveçse shërbejnë si hyrje për procesin lexues, kanë edhe natyrën e pjesëzave letrare si ato të rrëfimeve të funksionit prozaik, por që në fakt janë vetë dëshmi dokumentare të jetës së librit dhe vetë autorit. Ky lloj shkrimi, përsëritet edhe herë të tjera në libër në mënyrë më specifike, për të dëshmuar rrugëtimin përmes peripecive që kanë bërë që nga dekadat tashmë të largëta disa nga studimet që paraqiten këtu.

Kemi të bëjmë me një libër që thekson probleme të autoktonisë së lëndës burimore gjuhësore e mitologjike, simbolike dhe arketipore që duhet jo vetëm të na bëjnë krenarë, por të na shtyjnë për të kuptuar rrënjët tona kulturore, identitetin tonë dhe referimin tonë në pikëpamje historike. Luka evokon jo paqëllim se tek autorët antikë ai që quhej gadishulli Ilirik, quhej gjithashtu edhe gadishulli Evropian, faktografi që është anashkaluar nga shumë autorë akademikë. Nga ana tjetër libri propozon drejtpërdrejt si dhe edhe në mënyrë të nënkuptuar rivalizimin e simbolikës identitare, të mitit të lashtësisë, autoktonisë së hershme dhe pasurisë kulturore arketipore, siç janë miti i Rozafës, i lashtë sa vetë kulti i nënës së madhe, apo i simboleve heraldike dhe ikonografike të shmangura e të lëna në harresë.

Në metodë, libri mbështetet tek interdisiplinarizmi. Autori demonstroi dijet e thella në histori, mitologji, arkeologji, numizmatikë, antropologji e folklor, por thellimi i tij në dijet e gjuhësisë është mbresëlënës. Kjo tregon edhe vetë vlerën e studimeve si të plota nga perspektiva e të gjitha fushave të mundshme të studimit të çështjeve të shtruar për shqyrtim. Metodën, si duket e ka

bërë të domosdoshme vetë objekti i studimeve të çështjeve të lëna pezull nga dijetarët të mëdhenj apo vetë gjendja e tyre në nivel hipotezash të shkapërdara e të pakrahasuara. Këtë libër mund të lexohet edhe si një kritikë ndaj konkluzioneve të pavërtetuara. Tezat e tij Agron Luka i ka shqyrtuar gjatë në kohë prandaj dhe nuk janë të kursyera hapësirat tekstore. Nga ana tjetër vetë natyra e teksteve interdisiplinare është e tillë që dikton zgjerimin e tekstit për t'i dhënë hapësirë argumenti, secilës disiplinë që thirret në interpretim të çështjeve.

Libri Skodrinon, si një përmbledhje studimesh përbëhet në mënyrë dominuese nga pjesë që janë tërësisht origjinale dhe përmbajnë firmën e autorit, por disa të tjera, janë përvijime të punëve të mbetura në mes, nga i ati, i mirënjohuri Gjovalin Luka, për shkaqe që tashmë dihen. Nuk mungon edhe evokimi i kontributeve të ungjit të tij, Kolë Luka, njëri nga studiuesit dhe përkthyesit më me peshë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar në fushën e studimeve albanologjike. Këtu, dija, paraqet vlerën e saj si trashëgimi dhe si porosi e realizuar, duke na kujtuar se janë pikërisht mendimi dhe kultura ato që përbëjnë thelbin e ekzistencës sonë njerëzore, më shumë se çdo gjë tjetër.

Autori tregohet mjaft i ndershmë dhe fisnik teksa i përmend një e nga një të gjithë të gjithë personalitetet e shkencave me të cilët është konsultuar. Bëhet fjalë për konsulencat të drejtpërdrejta me autoritete të fushave të veçanta si Anton Fistani, Dhimitër Shuteriqi, Zija Shkodra, Willy Kamsi, Vangjel Toçi, por këto emra nuk vijnë ashtu thatë siç ndodh shpesh. Ata vijnë me gjuhën, argumentet dhe referimet e tyre, përmes dialogesh të gjalla të regjistruara me kujdes nga autori.

Libri është i pasur me teza të thella për secilën çështje që trajton. Disa nga studimet shtrajnë njëkohësisht më shumë se një çështje të vetme për shqyrtim dhe përmbillen natyrshëm me produktin e tezave të ndërlidhura. Tezat janë të mirë argumentuara dhe të formuluara qartë e në mënyrë bindëse. "Skodrinon..." meriton të konsiderohet si një arritje në fushën e albanologjisë sepse ofron mjaft teza që përforcojnë argumentet e etnogjezës e të përvijimësisë së qytetërimit dhe kulturës Iliro-Albano-Shqiptare. Libri gëzon gjithashtu vlerën e të ofruarit të dy niveleve të leximit: atë të lexuesit akademik dhe atë të lexuesit kureshtar e të pasionuar pas fushave të historiografisë.

Urime autorit, dhe na mbledhtë së shpejti në botime të tjera të kësaj rëndësie!

Përgatiti Ndue Sanaj

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION Kimay Produzione Giacche

